

# H Y L L I I D R I T Ë S

## E PËRKOHSHME KULTURORE - LETRARE

---

### *EDITORIAL*

E mira e përbashkët 3

### *IN MEMORIAM*

**Vittorio POSSENTI**  
Papa Benedikti XVI 5

### *GJUHËSI*

**Bardhyl DEMIRAJ**  
Fjalësi shqip në fjalorin trigjuhësh të Theodhor Kavaliotit (1770) 9

**Evalda PACI**  
Në përvjetorin e 90- të botimit të veprës “Gjurmime mbi  
tekstet e vjetra shqipe” 49

### *STUDIME LETRARE*

**Oreste PARISE**  
Francesco Antonio Santori e la nascita del romanzo albanese 60

**Flamur MALOKU**  
Lirika - Shenja e Fishtës 80

|                                                                                                                                                                                                          |            |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>Alfred ÇAPALIKU</b><br>Pesë poema të Kolë Thaçit                                                                                                                                                      | <b>92</b>  |
| <b>Albanë MEHMETAJ</b><br>Naim Frashëri dhe Virgjili - lexim krahasues                                                                                                                                   | <b>109</b> |
| <b>Ndue UKAJ</b><br>Poezia e Át Zef Pllumit                                                                                                                                                              | <b>122</b> |
| <b>Elsa SKËNDERI</b><br>Mbretëria e urisë në veprën “Rrno vetëm për me tregue”                                                                                                                           | <b>132</b> |
| <b>Agron Y. GASHI</b><br>Zef Zorba, ikona e avangardes letrare                                                                                                                                           | <b>143</b> |
| <b>Tringë DUKAGJINI</b><br>Misteri i kohës                                                                                                                                                               | <b>162</b> |
| <br><i>DOKUMENTE</i>                                                                                                                                                                                     |            |
| <b>Edmond MALAJ</b>                                                                                                                                                                                      | <b>168</b> |
| <br><i>RECENSIONE</i>                                                                                                                                                                                    |            |
| <b>Evalda PACI</b><br>Reflektime rreth botimit kritik e filologjik të veprës<br>“Il soldato albanese per l’impero ottomano del 1420”,<br>Aracne Editrice, Romë, 2021 përgatitur nga M. Bruci, O. Parise. | <b>175</b> |
| <br><i>REDAKSIA E BOTIMEVE FRANÇESKANE</i>                                                                                                                                                               | <b>182</b> |
| <br><i>ARKIVI I HYLLIT</i>                                                                                                                                                                               |            |
| <b>Át Gjergj FISHTA, O.F.M.</b><br>“Shtjelmat e Pegazit”                                                                                                                                                 | <b>185</b> |
| <b>Át Paulin MARGJOKAJ, O.F.M.</b><br>Episode historike                                                                                                                                                  | <b>194</b> |

BARDHYL DEMIRAJ

## Fjalësi shqip në fjalorin trigjuhësh të Theodhor Kavalitit (1770)

### 0 Fjalë hyrëse

Idea me ndërmarrë një edicion kritik të përmendoreve të hershme të shkrimit shqip me alfabet greqisht në Arealin Kulturor të Jugut erdhi dhe u ngjiz si projekt i veçantë dikur, aty nga fundi i vitit 2017, bash kur shkruesi i këtyre radhëve kishte përmbyllur ndërkohë projektin e vet afatgjatë të natyrës gjuhësore-filologjike mbi Arealin Kulturor të Veriut (Demiraj 2017). Ky projekt i parë u sendërtua përgjatë viteve 2006-2017 me botimin e pesë veprave të natyrës monografike, si edhe të një numri të konsiderueshëm studimesh gjuhësore-filologjike që zunë vend në periodikë të ndryshëm shkencorë, akte konferencash albanologjike të kohës, sikurse edhe në ndonjë përmbledhje kolektive.

Asgjëmangut, motivi për projektin e dytë ishte i njëjtë me të parin, për të mos vënë theksin patjetër në gamën e intensitetit të tij; dhe arsyeja për këtë është fare e thjeshtë, në mos triviale: trashëgimia e kulturës së hershme të shkrimit shqip me alfabet greqisht – sado e rrudhur qoftë kjo në vëllim dhe numër autorësh – nuk ka fare qasje, si në rrethet shkencore-intelektuale të kohës ashtu edhe te lexuesi i zakonshëm në hapësirën kompakte shqipfolëse, ndërkohë që në manualet enciklopedike dhe programet shkollore të grupmoshave të ndryshme autorët e zërave përkatës mjaftohen me të dhëna të përcipta biobibliografike, që jo rrallë kërkojnë rishikim. Prashtu nuk bëjmë aspak çudi, në rast se mëtojmë tash që do tekste relativisht të gjata dhe glosarë shqip me këtë alfabet nuk e kishin parë deri vonë dritën e botimit si edicione kritike më vete. Të tillë janë p.sh. ata në Kodikun Beratas (shek. XVIII – Demiraj 2019a), në *Εισαγωγική Διδασκαλία* (= Mësim hyrës, [Venedik] 1802 – Demiraj 2022a) me autor Mjeshtër Dhanilin, sikurse fjalësi shqip në fjalorin trigjuhësh në librin shkollor *Πρωτοπειρία* (= Përvoja të para, Venedik 1770) të Theodhor A. Kavalitit, të cilin e kemi bërë objekt të këtij shkrimi, deri edhe ndonjë tekst i vonë, por me të njëjtin orientim, siç është rasti me materialin shqip në Kodikun e Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822/23 – Demiraj 2020b).

Edicionin kritik të këtyre teksteve e shoqëruan ndërkohë po prej

nesh disa studime gjuhësore-filologjike mbi tri tekste të shkurtra, të mëhershme, siç janë dorëshkrimi shqip në Biblioteca Ambrosiana të Milanos (shek. XV-XVI – Demiraj 2019b), përpos atij të zbuluar rishtas në bibliotekën e Manastirit të Shën Trinisë në ishullin Chalki (shek. XVI/XVII – Çunga & Demiraj 2019<sup>[e]</sup>), sikurse edhe mbishkrimi në të ashtuquajturën Gravurë e Ardenicës (Terpo 1731 – Demiraj 2019c). Këto tri dëshmi ravijëzojnë së bashku fazën e parë të lëvrimit të kësaj kulture shkrimi shqip, e cila ngjitet deri në kapërcyell të viteve 30’ të shek. XVIII, duke bashkëbartur si tipar kryesor, përpos vendndodhjeve të ndryshme jashtë hapësirës shqipfolëse, edhe një farë pasigurie të autorëve me lëvruar shqipen me këtë alfabet.

Të tjera rrethana kushtëzojnë fazën e dytë të kësaj kulture, që dallon me fazën prijëse, përpos lëvrimit të saj brenda Arealit Kulturor ortodoks të Jugut, edhe për një tipar të ri, që feks sidomos në hartimin e glosarëve dy-, tri- deri katërgjuhësh. Bëjmë fjalë këtu për lëvrimin paralel e me të njëjtin alfabet të dy gjuhëve anase: të shqipes dhe të arumanishtes, të cilat gjëllinin e gjëllijnë sot e gjithë ditën në bashkëjetesë në zona të tëra etnografike, sidomos në Toskëri. Për to hyn gjithëherë dorëzanë një autor në cilësinë e klerikut ortodoks, me vendlindje dhe/ose formim të parë dhe të patëmetë shkollor në Voskopojë e me përkatësi etnike-gjuhësore, pas gjase, arumune, por që i zotëron mirë në komunikim të dyja gjuhët. Ai ndjek si qëllim kryesor afatshkurtër njohjen dhe përvetësimin e greqishtes si gjuhë mësimi dhe komunikimi në shkollë e me syzim afatgjatë deri në përdorimin e saj si *lingua franca* në jetën e përditshme, sidomos në tregti, përkatësisht si gjuhë liturgjike në jetën fetare dhe në marrëdhënie me institucionet e kultit.

Parë vetëm nga kjo perspektivë, pra pa dashur assesi të acarojmë sado përciptas gjakra të natyrës etno-nacionaliste, lejohe mi t’i bashkohemi me këtë rast vetëdijshtëm vëzhgimit të mprehtë që hodhi dikur në letër të bardhë Eqrem Çabej, sipas të cilit “Me Teodor Kavaliotin fillon periudha e shkurtër e kulturës arumune në Shqipëri.” (1936 31). Gjithsesi, vëzhgimet tona mbi këtë periudhë na lejojnë të shtyjmi fillesat e saj në prag të viteve 30’ të shek. XVIII, kur ngjërojmë për të parën herë tekste paralele shqip dhe arumanisht, që janë fiksuar në të ashtuquajturën Gravurë e Ardenicës (1731) e që kanë për autor igumenin e manastirit në fjalë, po-voskopojarin Nektar Terpo.

Një degëzim orientimi po aq afatgjatë, më saktë deri diku të përkundërt me atë të përmendur më lart, e vërejmë në një numër tekstesh liturgjike të mirëfillta shqip – lutje, psalme, himne –, të cilat na shfaqen gjithëherë si përkthime interlineare gjegjësesh greqisht, ndërkohë që do tekste të tjera të shkurtra e të natyrës predikuese-narrative që përcjellin përmbledhtas episode prej Bëmave të Apostujve i ndeshim vetëm në



gjuhën shqipe. Prashtu tekste dhe glosarë greqisht-shqip i ngjerojmë në Kodikun Beratas (shek. XVIII) dhe vetëm tekste në atë të Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822-1824). Shtojmë gjithashtu, se për nga përmbajtja, natyra dhe kompozimi ato i qëndrojnë shumë pranë kulturës së shkrimit shqip me alfabet origjinale, një traditë kjo paralele që mori formë dhe hodhi shtat prej gjysmës së dytë të shek. XVIII, sidomos te bashkësitë ortodokse shqiptare në Shqipërinë e Mesme (Durrës, Elbasan, Berat) e që ngërthen si e tillë një objekt hulumtimi më vete në të ardhmen.

Glosari trigjuhësh greqisht-arumanisht-shqip në librin shkollor *Πρωτοπειρία* (= Përvoja të para, Venedik 1770) me autor Theodhor Anastas Kavaliotin, të cilin po ia përcjellim lexuesit të “Hyllit të Dritës” në këtë numër të Hyllit tonë të Dritës, përmbyll edhe këtë ndërmarrje tonën me i mundësuar mjedisit shkencor-intelektual shqiptar e më gjerë të gjithë trashëgiminë e hershme të kulturës ortodokse të shkrimit të hershëm shqip me alfabet greqisht që njohim deri sot. Veçse, ndryshe nga veprat dhe kodikët e cituar më lart, ky glosar e ka parë dikur dritën e botimit pjesë-pjesë në disa numra të revistës “Leka” (Shkodër), e kjo falë ngulmit dhe punës entuziaste të rilindasit të vonuar dhe filologut autodidakt Ilo Mitkë Qafëzezi (1936/37). Ndër ribotimet jashtë hapësirës shqipfolëse të këtij glosari përgjatë shekullit të kaluar feks sidomos botimi filologjik i Armin Hetzer-it (Hamburg 1981), krahas riprodhimit anastatik të Harald Haarmann-it (Hamburg 1976) e së fundi të Exarchos (Αθήνα/Athëna 2016). Thuajse të gjitha këto botime kanë si tipar të përbashkët orientimin jo te një *editio princeps*, që konsiderohej atëbotë tërësisht i humbur, por te ribotimet e mëhershme filologjike të Johann Thunmann-it (Leipzig 1774) dhe të Gustav Meyer-it (AS V, Wien 1895).

Ndërkohë botës shkencore i janë bërë të njohura katër ekzemplarë të *editio princeps* të këtij libri (Peyfuss 2008), madje për ndonjërin syresh shumëkush ka qasje me e shfrytëzuar brenda kuadrit juridik përkatës, në faqe të ndryshme interneti, ndër to: <<http://vlahoi.net/vlahiki-glossa/protopeiria-kavallioti>>. Ky kontekst filologjik-virtual ishte për shkruesin e këtyre radhëve një shkas më shumë me ndërmarrë pas thuajse një shekulli një edicion të ri kritik kryesisht për lexuesin shqiptar, ku mbahen parasysht të gjitha sprovat dhe prurjet e derisotme në albanologji, rumunistikë dhe grecistikë. Nxitje shtesë përbëjnë sigurisht edhe njohuritë e fituara rishtas në shkencat historike albanologjike lidhur me personalitetin e Kavaliotit (Peyfuss 1985, 1989), për Voskopojën dhe rolin e saj në zhvillimin e jetës tregtare-urbane (Peyfuss 1975; Xhufi 2018), për formimin humanist me qendër Akademinë e Re dhe shtypshkronjën në atë qytet (Peyfuss 1989), deri edhe në përbërjen e tij etnike demografike përgjatë shekujve XV-XVIII

(Xhufi 2010; Duka 2019) sikurse në analizat e detajuara mbi shkaqet që shoqëruan gjithë ato zigzage në zhvillimin dhe rrëgjimin e jetës në këtë qytet përgjatë shek. XVIII (Xhufi 2010, 2018). Përpos vëzhgimeve të mprehta mbi veprën *Πρωτοπειρία* të Kavaliotit në përgjithësi (Peyfuss 2008) dhe sidomos ato gjuhësore-filologjike mbi glosarin trigjuhësh në të (Hetzer 1981, 1983), disponojmë ndërkohë edhe frytet fatlume dhe emancipuese të analizave induktive shumëplanëshe të Xhevat Lloshit (2006, 2008, 2018), i cili sendërton me fjalë e me vepër vëzhgimin e mprehtë të Çabejt, të cituar më lart.

Përmbledhëm kështu thukët përpos objektit dhe qëllimit të studimit edhe atë çka syzojmë t'i përcjellim lexuesit potencial në këtë shkrim si prurje tonën individuale, në mënyrë që ai të përditësohet dhe dikur – e pse jo! – të marrë pjesë aktive vetë në këtë diskurs.

## 1 Korniza para- dhe peritekstuale

### 1.1 Theodhor Anastas Kavalioti

Përshkrimi biobibliografik i jetës, i qasjeve dhe i prurjeve intelektuale të (shq.) Theodhor Anastas Kavaliotit (= Kavalioti) si autor i fjalorit në fjalë që sendërton pjesën e parë në librin shkollor për nxënës fillestarë *Πρωτοπειρία* (= Përvoja të para, Venedik 1770), i bashkon në unison të gjithë ata studiues që janë marrë me personalitetin e tij në përfundimin se jetën dhe aktivitetin e tij intelektual nuk e njohim shterueshëm, anipse qysh herët janë bërë kërkime të shumta në këtë drejtim. Atë çka dimë, por edhe çka nuk dimë ende sot, mund ta përmbledhim thukët, duke u mbështetur kryesisht në rezultatet e hulumtimeve të mirëfillta biobibliografike të studiuesve të njohur Victor Papacostea (1931/2 I, II; 1937) dhe Max Demeter Peyfuss (1985, 1989)<sup>1</sup>, si vijon:

- Emri i parë (shq.) Theodhor ~ (arum.) Teodor ~ (gr.) Theodōros (= Θεόδωρος) përcjell njëherësh përkatësinë fetare të besimit të krishterë ortodoks të autorit, ndërkohë që mbiemri dygjymtyrësh që e pason atë, krahas kësaj përkatësie, kumton natyrshëm linjën atërore të familjes së tij (shq.) Anastas ~ (arum.) Anastasie ~ (gr.) Anastasios (= Ἀναστασίος), sindëkur gjymtyra e fundit – ndoshta (?) – edhe vendin origjinar të familjes, përkatësisht të linjës atërore (shq.) Kavalioti ~ (arum.) Cavallioti ~ (gr.) Kaballiōtēs

<sup>1</sup> Burimi biografik më i hershëm dhe i sigurtë është Thunmann (1774). Gjithsesi, qoftë edhe për arsye vendi jemi përpjekur të shmangim me këtë rast referenca të mëparshme dhe të pafundme biobibliografike, të cilat janë rrokur me akribi marramendëse prej Peyfuss-it në dy studimet e cituara më lart. Në to referohet hollësisht sidomos mbi punimet e hershme të dijetarëve grekë K. N. Sathas (Neohellēnikē Philologia. En Athēnais 1868) dhe G. I. Zabiras (Nea Ellas ē Ellēnikon Theatron. En Athēnais 1872). Punimet e Papacostea-s janë ribotuar më vonë edhe në një vëllim postum shkrimesh të zgjedhura (București 1983).

(= Καβαλλιώτης). Kjo e fundit ka joshur sipas rastit studiues të ndryshëm që të përsiasin njërën ndër dy qendrat urbane në Ballkan me tingëllim të ngjashëm në morfemën bazë, si p.sh.: (gr.) Kabala (= Καβάλα) në Traki ase Maqedoninë Juglindore / Greqi e sotme<sup>2</sup> ose (shq.) Kavaja në Shqipërinë e Mesme<sup>3</sup>.

- Se si dhe përse kjo familje erdhi dhe u vendos në Voskopojë, kjo rrethanë, për mungesë dokumentimi historik, jet e mbetet enigmë. Ndokush që mëton vendin e saj origjinar në Kabala e argumenton këtë shpërngulje me ekzodin tragjik që përjetuan sidomos shtresat intelektuale dhe kleri ortodoks pas rënies dhe uzurpimit të Konstandinopojës (1453) prej osmanëve. Të tjerë që parapëlqejnë Kavajën, mëngojnë t'i referohen aktivitetit të kësaj qendre tregtare-urbane që shërbente deri vonë si një lidhëse për qarkullimin e mallrave me portin e Durrësit<sup>4</sup>.
- Në vijim, gjithë çfarë ka lidhje me përkatësinë etnike-gjuhësore të Kavaliotit e të familjes së tij në pikëpamje dokumentare nuk i kapërcen sot për sot kufijtë e hamendësisë dhe të legjendës. Prashtu nuk bëjmë aspak çudi, përse – falë emrit dhe personalitetit të tij në kohën kur veproi – studiues të ndryshëm që u takojnë ndoshta rretheve të caktuara shkencore-intelektuale me bazë gjuhësore-etnike mëtojnë më së shumti përkatësinë e tij në njërën ndër dy bashkësitë etnike që gjëllinin atëbotë në bashkëjetesë në Voskopojë, pra e mirënjohin Kavaliotin: a) si arumun; c) si shqiptar, deri edhe c) si pinjoll i një martese të përzier shqiptaro-arumune, më rrallë edhe d) si grek<sup>5</sup>. Pavarësisht nga këto përsiatje, ia vlen të mbajmë parasysh që Kavalioti d.v. vetëquhet *Voskopojari*, khs.: (në titullin e traktatit të fizikës) Θεοδώρου Αναστασίου Καβαλλιώτου τοῦ ἐκ Μοσκοπόλεως ose (në atë të gramatikës) Θεοδώρου Αναστασίου Καβαλλιώτου Μοσκοπολίτου<sup>6</sup> e në rastin tonë konkret nuk ka kurrfarë arsyeje të vëmë në dyshim praninë e emrit dhe të rolit të tij edhe në trashëgiminë e kulturës greke-ortodokse në këto vise ballkanike e më gjerë, qoftë kjo edhe falë formimit të tij humanist të patëmetë e me nota të theksuara të iluminizmit neohelen të kohës, pra pa dashur t'i mëshojmë këtu vetëm aktivitetit të tij filozofik-teologjik si shërbyes besnik i Kishës Ortodokse greko-bizantine, e

<sup>2</sup> Për bashkëlidhjen e kësaj çështjeje deri edhe me vendlindjen e Kavaliotit shih hollësisht Papacostea 1931/2 I 396vv. dhe Peyfuss 1985 384v.; së fundi Kekridi 1991 283.

<sup>3</sup> Së fundi Lloshi 2006 64.

<sup>4</sup> Peyfuss 1985 384v.; 1989 150v.

<sup>5</sup> Nuk mungon në diskursin e derisotëm intelektual as emërtimi 'epirot' si banor i Epirit e si i tillë si folës nativ i të tria gjuhëve në fjalë. (Papacostea 1931/2 I 390)

<sup>6</sup> Shih Papacostea 1931/2 I 398; Peyfuss 1985 384; 1989 151.

cila atëbotë, njëlloj si pushteti osman, nuk i përfillte dasitë etnike-gjuhësore brendapërbrenda bashkësive e shtresave sociale të të njëjtit besim a konfesion (*milet*).

Asgjëmangut, vëzhgimet e mprehta të natyrës gjuhësore-filologjike mbi fjalësin shqip në Πρωτοπειρία që kanë realizuar Hetzer-i (1981, 1983) dhe sidomos Lloshi (2006, 2008, 2018) qartësojnë bindshëm statusin etnik-gjuhësor të Kavaliotit si folës nativ i arumanishtes e njëherësh njohës relativisht i mirë i shqipes së folur, përkatësisht zotërues i greqishtes, parë kjo sidomos si gjuhë kulture dhe liturgjike në mjedisin ortodoks bashkëkohor ku vepronte.

- Vetë Kavalioti duhet të jetë lindur po në Voskopojë aty rreth vitit 1718 (?)<sup>7</sup> si pinjoll i familjes anase që kishte për zot mjeshttrin rrobapqepës me emrin (shq.) Anastas (= gr. Anastasios), emër i dokumentuar së paku në dy burime arkivore (AQSH) qysh në vitin 1721, përkatësisht më 1729<sup>8</sup>.
- Po në Voskopojë Kavalioti mori formimin e parë, por solid në shkollën greke të qytetit që drejtohej atëbotë prej mësueve të njohur Ioannes Chalcheus dhe Sebastos Leontiadës. Formimin e mëtejshëm në teologji dhe filozofi Kavalioti e gëzoi pas gjase në Janinë në vitet 30' të atij shekulli, ndoshta pranë Eugenios Bulgarës (1716-1806) ose ithtarëve të tij si njëri ndër përçuesit e rrymës së iluminizmit neohelen<sup>9</sup>.

<sup>7</sup> Peyfuss 1989 151 (shën. 266) na kumton se viti i lindjes së Kavaliotit dëshmohej si më \*1728, veçse, sipas tij, vështirë se mund të tumiret, qoftë edhe për faktin se leksioni i tij në dorëshkrim mbi 'Logjikën' datohet me siguri në vitin 1743, çka lë të kuptohet që Kavalioti ta kishte shkruar atë në një moshë jo më shumë se 15 vjeç. Gjithsesi viti 1728 rezulton i mirëqenë edhe falë përlllogaritjes së bërë prej kumtit të Thunmann-it (1774 177v., shën. g – me ndërmjetësim të informantit të tij të sigurt, Konstandin Haxhi Xhehanit si ish-nxënës i Kavaliotit) se Kavalioti ishte atëbotë plot 46 vjeç. Shih edhe Papacostea 1931 399. Asgjëmangut është mirë të shqyrtohet rishtas edhe viti i parë (1743) i dorëshkrimit në fjalë.

<sup>8</sup> Peyfuss 1989 151, shën. 263. Khs. edhe të dhënat e hershme të Thunmann-it (1774 179v.) që na përcjell informacion të dorës së parë prej dëshmitarit okular Konstandin Haxhi Xhehani (= Konstantinos Chatze Tzechane). Peyfuss (1985 384vv.; më parë Papacostea *loc. cit.*) ka ndjekur nga afër edhe gjurmët e familjes Kavalioti që të çojnë deri në Rumani në shek. XIX.

<sup>9</sup> Sipas Peyfuss-it (1989 152v.) ky kumt nuk është i sigurt e aq më pak edhe rrjedhojat e tij që kanë nxitur shumë studiues të përsiasin një bashkëlidhje të natyrshme me Bulgarës e më tej flirtimin e Kavaliotit me idetë iluministe të Gottfried Wilhelm Leibniz, Christian Wolff etj. Të tjerë mëngojnë të sjellin në analizë ndikimin e fuqishëm të iluministëve francezë Nicole Malebranche e René Decartes. Në këtë rast vjen në shqyrtim ndërmjetësimi i dijetarit të njohur grek Metodius Antrakitës, tek i cili ishte formuar (në Padova të Italisë) Sebastos Leontiadës, mësuesi i Kavaliotit në shkollën e vendlindjes. Shih edhe Thunmann 1774 177v. e më tej Papacostea 1931/2 I 399vv. dhe II 67vv., i cili ka ndikuar fuqishëm historiografinë e mëvonshme shqiptare.

- Pas studimeve ai kthehet rishtas në Voskopojë, ku martohet<sup>10</sup>, vishet prift e bëhet protopapá, duke dhënë po ashtu mësim në shkollën teologjike dhe tregtare të qytetit, që u themelua më 1744. Në vitin 1746 atë e ndeshim si drejtor të kësaj shkolle, e cila në vitin 1750 riorganizohet nën emrin *Akademia e Re* (= rum. *Academia Nouă* ~ gr. Νέα Ακαδημία).
- Përgjatë periudhës së angazhimit të tij intelektual-klerikal Kavalioti thuhet të ketë ndërmarrë disa udhëtime jashtë vendlindjes, ndër të cilat së paku njëri, ai në Venedik më 1770, do parë si i sigurt, meqë rezulton të ketë asistuar aty po atë vit botimin e librit të vet *Πρωτοπειρία*<sup>11</sup>. Ndonjë tjetër udhëtim, si p.sh. ai në Konstandinopojë, nëmos edhe një i dytë në disa vende në Perëndim të Europës – ndër të tjera edhe në Gjermani e Hungari –, mbeten ende të verifikohen bindshëm. Nuk dihet gjithashtu, nëse Kavalioti ndodhej në Voskopojë në vitin 1769, kur qyteti u plaçikt dhe u dogj me rrënjë e me degë prej bandave të borxhlinjve që siguronin kundrejt pagesës qarkullimin e mallrave tregtare të qytetit drejt portit të Durrësit a gjetkë. Gjithsesi, në fillim të viteve 70' Kavaliotin e ndeshim rishtas në Voskopojë. Pikërisht në këtë periudhë, të vështirë me mbijetuar, në ndonjë dokument arkivor (AQSH) Kavalioti rezulton të ketë qenë edhe pjesëtar i rufetit (esnafit) të bakajve të atij qyteti<sup>12</sup>,
- Kavalioti mbylli sytë për të fundit herë po në Voskopojë më 22 gusht 1789 (= 11 gusht 1789 – kal. ort.)<sup>13</sup>, pasi kishte vuajtur orgjinë shkatërruese të radhës në qytetin e tij, tashmë të braktisur e të trishtë.

Me këto të dhëna të shprazëta biografike përmbledhin shkallën e derisotme të njohjes historiani Peyfuss (1985, 1989, 2008), më tej edhe studiues me stimë si Hetzer (1981 17vv.; 1983) e së fundi Lloshi (2006 88), i cili nuk mungon në asnjë rast t'u referohet rezultateve sado të brishta të kërkimit prej hulumtuesit të apasionuar dhe autodidakt të

<sup>10</sup> Fryt i martesës me një vashë vendase prej fisit Kurani ishte djali që mori emrin e gjyshit Anastas, i cili duhet të ketë ecur në gjurmët e të atit, meqë në vitin 1808 rezulton të ketë qenë i angazhuar në Miskolc (Hungari) si kryeprift (protopapá). Emigrimi i familjes u kushtëzua padyshim prej plaçkitjeve dhe shkretimeve në vazhdimësi që përjetoi qyteti i Voskopojës në fund të shek. XVIII. Hollësisht për këtë Peyfuss 1985 385v.

<sup>11</sup> Për këtë sillet si dëshmi kumti i dijetarit serb Dositej Obradović, që shkruan në autobiografinë e tij, se ishte njohur me Kavaliotin atë vit në Venedik, ku kishte ardhur për botimin e librit. Shih së fundi Peyfuss 1989 153, shën. 277 me referencat bibliografike përkatëse.

<sup>12</sup> Peyfuss 1985 385 me referim të një dokumenti arkivor (AQSH) që mban datën 5 shkurt 1784.

<sup>13</sup> Peyfuss 1989 151, shën. 265.



arkivave dhe bibliotekave kishtare ortodokse, Ilo Mitkë Qafëzezit d.v. (vitet 20-/30-të të shek. XX).

### 1.1.1 Personaliteti i Kavalitit në historiografinë shqiptare

Në disa studime të tij Lloshi (2006, 2008, 2018) nuk lë pa përdorur as bodecin ndaj paraqitjes së personalitetit dhe veprës së Kavalitit në historiografinë zyrtare shqiptare sidomos në gjysmën e dytë të shek. XX, ku nga njëra anë, sipas tij, është mbajtur si të thuash 'fshehur', në mos edhe retushuar përkatësia e tij gjuhësore-etnike arumune e nga ana tjetër është hiperbolizuar edhe roli i tij në përfundimin e një debati gjoja të shëndetshëm filozofik-teologjik dhe sidomos në gatimin e frymës së iluminizmit evropian perëndimor në mjediset intelektuale shqiptare në Arealin Kulturor të Jugut, madje me orientim edhe ndaj Veriut të Shqipërisë<sup>14</sup>.

Asgjëmangut, pa dashur t'u mëshojmë fort këtyre qëndrimeve të dikurshme që janë padyshim të pagjetura e të nxitura prej paketës ideologjike pseudokombëtare dhe dhunës strukturore informale të regjimit të dikurshëm në fuqi, e si të tilla nuk kanë të bëjnë as me qëllimin që i kemi vënë vetes në këtë punim, mendojmë se personaliteti dhe vepra e Kavalitit janë padyshim edhe pjesë e historisë së kulturës shqiptare, sikurse e lëvrimin të shkrimit shqip dhe arumanisht. Për më tepër mjafton të përmendim këtu se nuk mungojnë as ish-nxënës të tij që kanë ecur në hullinë e hapur prej mësuesit të vet, si p.sh. Mjeshtër Dhanili<sup>15</sup> e, pse jo (!), edhe Theodhor Haxhifilipi që kultivoi shqipen me alfabet origjinal<sup>16</sup>, e po ashtu, së paku njëri ndër autorët e Kodikut Beratas (shek. XVIII) që ka marrë e kopjuar pjesë nga fjalori i Kavalitit, në mos e ka pasur atë si sinor orientues (f. 75-76, 87-102 – Demiraj 2019a). Parë nga kjo perspektivë, vjen e fiton gjithnjë e më shumë kuptim, madje edhe zgjerim spektri rrezatues, kumti i dikurshëm i Eqrem Çabejt (1936 31): "Me Teodor Kavalitin fillon periudha e shkurtër e kulturës arumune në Shqipëri."

Le të ndalemi në vijim thukët pikërisht në këto prurje të Kavalitit:

### 1.1.2 Prurje të aktivitetit intelektual të Kavalitit

Formimi i plotë humanist dhe teologjik i Kavalitit në Voskopojë dhe

<sup>14</sup> Një situatë tragjikomike përjeton lexuesi kur ngjeron nga afër analizat dhe gjykimet e Lloshit ndaj punimeve të një numri studiuesish të njohur në historiografinë e kulturës shqiptare, si p.sh. Alfred Uçi (1966, 2004) e po ashtu do hartues veprash të natyrës enciklopedike e të historisë e albanologjisë, ndër ta edhe prurjet e Jup Kastratit (2000 281-308).

<sup>15</sup> Së fundi Demiraj 2022a.

<sup>16</sup> Së fundi Demiraj 2022b.

Janinë, sikurse, madje sidomos, aktiviteti i tij klerikal dhe intelektual si kryepriфт e njëherësh mësues në shkollën tregtare-fetare të qytetit deri edhe si drejtues i Akademisë së Re qysh prej themelimit të saj (1750), ndikuan pa dyshim pozitivisht në prurjet e tija, të regjistruara – qoftë edhe pjesërisht (!) – në formën e produktit intelektual të shtypur apo në dorëshkrim.

Ndër tri veprat e tij të shtypura që njihen deri sot e që gjëlljnë ende si raritete bibliotekare, dy të parat janë shtypur bash në shtypshkronjën e Voskopojës (1731-1769<sup>17</sup>), ndërsa e treta një vit pas shkatërrimit të saj në Venedik (1770). Me autorësi të Kavaliotit ruhet gjithashtu një trilogji me material të natyrës didaktike në dorëshkrim, pjesë të së cilës janë kopjuar pas gjase prej duarsh të ndryshme. Këtij fondi i shtohen hamendësisht edhe tri materiale në dorëshkrim që në fakt citohen shpesh, anipse (ndërkohë) i kanë bjerrë gjurmët, në mos nuk kanë pasur ndonjëherë të tilla. Këtë trashëgimi e regjistron së fundi Peyfuss (1989 146vv.; 154v.; 156vv.; 199v.), si vijon:

#### **A. Vepra të shtypura**

1. 1750: Theodōros Anastasiu (KABALLIŌTĒS): Ὀκτώηχος.

Titulli i plotë në ballinë: Ὀκτωή- | ΧΟΣ. | ΝΕΩΣΤΙ | Μετατυπωθεῖσα καὶ διορθωθεῖ- | σα Παρὰ Κυ̅ θεοδόρου Ἀναστασίου τοῦ ἐκ Μοσχοπόλεως. | Ἐν τῇ τυπογραφίᾳ τοῦ Ὁσίου | καὶ θεοδόρου Πατρὸς ἡμῶν | Ναοῦμ τοῦ θαυματουργοῦ. τοῦ | ἐν τῷ Λιβανίσχῳ Διαβόλεως | κειμένου. | α ψ ν. | Ἐν Μοσχοπόλει.

Formati 8° (17 x 11,5 cm), 206 f.

*Shën.*: I vetmi ekzemplar ekzistues është i dëmtuar dhe me mungesa.

U zbulua prej Peyfuss-it në Szentendre (Hungari) në Bibliotekën e Peshkopatës Serbe Buda. Vendndodhja në atë bibliotekë me sign.: Koleksioni i Manastirit në Grabovac 760.

2. 1760: Theodōros Anastasiu (KABALLIŌTĒS): Εἰσαγωγή γραμματικῆς.

Titulli i plotë në ballinë: Εἰσαγωγὴ ΓΡΑΜΜΑΤΙΚΗΣ. | Παρὰ τοῦ Αἰδεσιμωτάτου καὶ Ἑλλογιμωτάτου | διδασκάλου τῆς ἐν Μοσχοπόλει νεωστὶ ἰδρυ- | θείσης Ἀκαδημίας, καὶ Μεγάλου Πρωτοπαπᾶ, | καὶ Ἱεροκλήρου τοῦ Ἀγιωτάτου θρόνου | τῆς Πρώτης Ἰουστινιανῆς Ἀχρειδῶν, | καὶ τῆς θεοσώστου Πολιτείας Μοσχο- | πόλεως Κυρίου θεοδόρου Ἀνα- | στασίου Καβαλιώτου Μοσχο- | πολίτου, συναρμοσθεῖσα | εἰς εὐχέρειαν τῶν | Πρωτοπείρων. | Νῦν πρῶτον τύποις ἐκ δοθείσα δαπάνη τοῦ | ἐν τιμοτάτου, καὶ χρησιμωτάτου Κυρίου Ἀντα- | νίου χατζῆ Γεωργίου Μποῦε, εὐπατρίδου Μο- | σχοπόλεως. | Ἐν τῇ

<sup>17</sup> Peyfuss (1989) i ka kushtuar aktivitetit të kësaj shtypshkronje një monografi të tërë.

Τυπογραφία, τοῦ ὁσίου, καὶ Θεοδώρου ἱ Πατρὸς ἡμῶν Ναοῦμ  
τοῦ θαυματουργοῦ. ἱ Ἐν Μοσχοπόλει. α ψ ξ.

Formati 8° (16 x 10,5 cm), B11 + 144 f. (f. 7 ose 8 e papaginar)

*Shën.*: \*1 Ekz. në Athos; Sig.: Meg. Laura: 2.18.K; 2 Ekz. në Bibl. e Akad.  
së Bukureshtit: CVR 323 A (I.629.961), burimi: Kolegji i Shën Savas  
në Bukuresht.; 3. Ekz. Me mungesa në BKS.

3. 1770: Theodōros Anastasiu (KABALLIŌTĒS): Πρωτοπειρία (shih  
§1.2.1)

#### **B. Vepra në dorëshkrim**

4. 1743 dhe 1755: Λογικὴ πραγματεία

Titulli i plotë në ballinë (1755)<sup>18</sup>: [αφνε. Ἀνθεστηριῶνος πέμπτῃ  
μεσοῦντος] λογικὴ πραγματεία συναρμολογηθεῖσα παρὰ τοῦ  
ἱεροσοφολογιωτάτου πρωτοπιπᾶ Μοσχοπόλεως καὶ διδασκάλου  
κυρίου Θεοδώρου Ἀναστασίου Καββαλιώτου καὶ παρ' αὐτοῦ  
ἐκδοθεῖσα ἐν τῇ τῆς ἰδίας πατρίδος νεωστὶ ἰδρυθείσῃ σχολῇ.

Formati i variantit të dytë: 28 x 20 cm., me rreth 100 fl.

*Shën.* Varianti më i vjetër, i gjetur prej Ilo Mitkë Qafëzezit në bibliotekën e  
manastirit të Apostujve në Vithkuq, nuk është më i disponueshëm.

Varianti i vitit 1755 ndodhet ndërkohë në bibliotekën e Akademisë  
së Shkencave të Bukureshtit. Sipas Papacostea-s (1931/2 I 388) kemi  
këtu një autograf të Kavalitit, që ishte në pronësinë e dikurshme të  
djalit të tij. Peyfuss (1989 154) nuk përjashton mundësinë e një autografi  
të të birit.

5. 1752 (2 ekz.: Bibl. Akad. së Bukureshtit dhe AQSH): Φυσικὴ  
πραγματεία

Titulli i plotë në ballinë (Papacostea 1931/2 I 388): Φυσικὴ πραγματεία  
συντεθεῖσα παρὰ τοῦ σοφολογιωτάτου διδασκάλου κυρίου  
Θεοδώρου Ἀναστασίου Καββαλιώτου τοῦ ἐκ Μοσχοπόλεως,  
καὶ παρ' αὐτοῦ ἐκδοθεῖσα ἐν τῇ τῆς ἰδίας πατρίδος νεωστὶ  
ἰδρυθείσῃ σχολῇ.

Formati i variantit të Bukureshtit (Papacostea 1931/2 I 390): 32 x 21 cm.,  
me 228 f., ndërsa ai në AQSH me sig.: Kodiku i Beratit nr. 74 – F  
488, D 74 (Rëmbeci 2018 418vv.): 19 x 15, me 153 fl.

*Shën.*: Sipas Peyfuss-it (1989 154v.) ekzemplari në Bibliotekën e Akade-  
misë së Bukureshtit është një autograf i Naum Anastasiu Ntata,  
ish-nxënësi të Kavalitit, ndërsa Papacostea (1921/2 390) vëren  
se edhe ky ekzemplar ka kaluar nëpër duart e djalit të Kavalitit.  
Po sipas Peyfuss-it ekzemplari në AQSH mund të jetë autograf i  
Kavalitit. Gjithsesi ai rezulton të ketë qenë në pronësi të parë të  
papá Evret Bendelas. (Rëmbeci 2018 418vv.)

<sup>18</sup> Sipas Papacostea-s 1931/2 I 387vv.



6. 1752 (shtojcë e lidhur bashke me nr. 5): Μεταφυσική  
Titulli i plotë në ballinë (Papacostea 1931/2 I 388): Μεταφυσική συντε-  
θείσα παρὰ τοῦ αὐτοῦ ἱεροκῆρυκος καὶ πρωτοπαπᾶ Θεοδώρου  
Ἀναστασίου Καββαλιώτου.

*Shën.* Materiali është i lidhur si shtojcë më vete në të dy ekzemplarët  
ekzistues të tekstit të Logjikës, andaj edhe Peyfuss-i (1989 154v.)  
nuk e konsideron si pjesë e veçantë në trilogjinë filozofike të  
supozuar, por thjesht dhe vetëm si shtojcë e vëllimit të “Fizikës”.  
Tjetër qëndrim ngjërojmë në historigrafinë rumune dhe shqiptare.

### C. *Vepra të humbura (?)*

Përpos kësaj trashëgimie të sigurt si produkt i mirëfilltë intelektual që  
ka për autor Anastas Kavaliotin, në traditën e hulumtimit bibliografik  
mbi Arealin Kulturor ortodoks të Jugut ndeshim jo rrallë hamendje  
dhe legjenda me emrin e tij. Kështu p.sh. atij i dedikohet, më saktë i  
dedikohet dikur, edhe përkthimi në shqip i Ungjijve, në mos i gjithë  
Biblës. Burimin e kësaj ngatërrese, të përsëritur shpesh në studime  
të kësaj natyre, Peyfuss-i (1989 155v., shën. 292) e heton së pari në  
shkrimet Hahn-it (AS I, 1853, 296v.), ku, falë emrit të parë të njëjtë,  
ndërndërrohet autorësia e elbasanasit Theodhor Haxhifilipi me atë  
të voskopojarit Theodhor Kavalioti. Shkrime të tjera fantazma si  
botime të shtypshkronjës së Voskopojës që i dedikohen Kavaliotit prej  
studiuësish të ndryshëm në kohë të ndryshme janë regjistruar po prej  
Peyfuss-it në shtojcën “VI. Fantazma të Voskopojës” (1989 196-201)  
siglat 8 – H’, 10 – I’ dhe 13 – II’<sup>19</sup>. Po mjaftohemi në vijim vetëm me  
përmendjen e titujve:

7. 1750. Theodoros Anastasiu KABALLIOTES: Ἐπη τινὰ αὐτοῦ  
χειρόγραφα πρὸς τὸν ἐξαρχικῶς ἐν Βοσκοπόλει ἐπιδημήσαντα  
Ἰωαννικίου Χαλχηδόνοιο ἐν ἔτει 1750 μαΐου κ’ ὧν ἡ ἀρχὴ „Βῆθι  
φίλη πόλεων, θέε γῆ τέκος.”
8. Theodoros Anastasiu KABALLIOTES: Περὶ τῆς ἐν Μοσχοπόλει  
Ἀκαδημίας.
9. Me vellone legjendës, të fiksuar me siglën 10–I’: [rreth 1770] Λεξικὸν  
ἐλληνικὸν ἀπλοῦν βλαχικὸν καὶ ἀλβανικὸν. Μοσχοπόλις<sup>20</sup>,  
kundron Peyfuss (1989 199) një botim të hamendësuar të fjalorit  
trigjuhësh në librin shkollor Πρωτοπειρία të Kavaliotit, të cilit do  
t’i përkushtohemi konkretisht në rubrikat që vijojnë.

<sup>19</sup> Peyfuss (1989 196vv.) rendit me akribi marramendëse edhe radhën e studiuësve  
që thjesht kanë përsëritur kumtet e njëri-tjetrit, por pa i konsultuar dhe verifikuar  
konkretisht ato.

<sup>20</sup> Shih edhe §2.2 për materialin e supozuar në dorëshkrim në Malin Athos.

## 1.2 Libri shkollor Πρωτοπειρία (Venedik 1770)

Sado i lartë të ketë qenë niveli dhe kumti diturak që përcjellin veprat e botuara ose në dorëshkrim të Kavaliotit – sigurisht në varësi këto edhe me kohën, kur u shkruan –, vetëm doracaku Πρωτοπειρία mundi të mbijetojë motet si produkti intelektual më i njohur e për rrjedhojë edhe më i rëndësishëm i pendës së tij. E këtë status ky libër, më saktë fjalori trigjuhësh greqisht-arumanisht-shqip i rrokur në të, pritet ta gëzojë ende në një të ardhme sado të largët. Gjithsesi, arësyeja për këtë nuk ka të bëjë assesi me qëllimin a synimet dhe rrethanat, për të cilat dhe në të cilat ky libërth dhe ky fjalorth u hartuan mirëfilli, çka vjen me thënë me përdorimin e tij si doracak për nxënës kombësish të ndryshme (arumune dhe shqiptare), që sapo kishin hyrë në një shkollë me program mësimor greqisht e ku greqishtja pas gjithë gjasash do të përdorej edhe si gjuhë ndërkomunikimi në zhvillimin e atij programi. Andaj edhe përvetësimi i saj parakuptonte sythin e parë didaktik në program.

Asgjëmangut, askush nuk është më sot në dijeni, nëse dhe sa kohë ky libër mund a duhet të jetë përdorur në funksionin e tij fillestar, qoftë edhe në Voskopojën e shkretuar herë pas here në vitet 70' e 80' të shekullit XVIII. Përndryshe rrugëtimet, shqyrtimi dhe shfrytëzimi gjithëfarësh i fjalorit trigjuhësh të përfshirë në të, rezulton të ketë qenë gjithherë i pranishëm si material faktik në fusha të ndryshme të hulumtimit gjuhësor-filologjik, si në rumunistikë (studimet arumune), albanologji, grecistikë, madje me qasje të dorës së parë në studime të ndryshme të natyrës historike e deri në sosh që u takojnë fushave të gjuhësisë ballkanike, të tipologjisë areale e të sociolinguistikës. Prashtu nuk kemi përse bëjmë aspak çudi që Kavalioti konsiderohet sot si pararendës deri edhe 'stërgjysh i balkanologjisë' (Peyfuss 2008 85), përderisa edhe ky fjalor ose pjesë të tij janë ribotuar e dorëshkruar shumë herë deri sot.

Riprodhimi diplomatik i fjalorit trigjuhësh së bashku me edicionin kritik të pjesës shqip përbën në thelb edhe qëllimin kryesor që i kemi vënë vetes në këtë punim, parë ky si ribotimi i dhjetë i tij.

### 1.2.1 Botimi i parë – *editio princeps*

Botimi i parë (*editio princeps*) i librit shkollor Πρωτοπειρία (= Përvoja të para – Venedik 1770, formati 8°, 104 + 8 f.) ka përjetuar gjithashtu zigzage në rrugëtimin e tij në kohë dhe hapësirë. Shumë çështje mbeten të pasqaruara shterueshëm, si p.sh. tirazhi i botimit, dërgesa e tij në destinacion dhe përdorimi po aty (në Voskopojë) si libër shkollor, deri edhe nëse ka përjetuar ose jo më pas ribotime të plota në funksionin e vet fillestar.

Lidhur me strukturën përmbajtësore të librit mund të përmbledhim paraprakisht thukët, sa vijon:

- Ballina (pa numër faqeje por e mbajtur parasysh në paginim) me titullin:

ΠΡΩΤΟΠΕΙΡΙΑ  
ΠΑΡΑ  
ΤΟΥ ΣΟΦΟΛΟΓΙΩΤΑΤΟΥ  
Καὶ Αἰδεσιμωτάτου Διδασκάλου  
Ἱεροκλήρου,  
Καὶ Πρωτοπαπᾶ Κυρίου  
ΘΕΟΔΩΡΟΥ ἈΝΑΣΤΑΣΙΟΥ  
ΚΑΒΑΛΛΙΩΤΟΥ  
ΤΟΥ ΜΟΣΧΟΠΟΛΙΤΟΥ  
ΞΥΝΤΕΘΕΙΣΑ,  
Καὶ νῦν πρῶτον τύποις ἐκδοθεῖσα  
Δαπάνῃ τοῦ Ἐντιμοτάτου, καὶ Χρησιμωτάτου  
Κυρίου Γεωργίου Τρίκουπα, τοῦ καὶ Κοσ-  
μήσκη ἐπιλεγομένου ἐκ Πατρίδος  
Μοσχοπόλεως.  
ἘΝΕΤΙΗΪΝ,  
α ψ ό. 1770.  
Παρὰ Ἀντωνίῳ τῷ Βόρτολι.  
SUPERIORUM PERMISSU, AC PRIVILEGIO .<sup>21</sup>

- Faqe prapa e ballinës: bosh.
- Faqe 3: Parathënie e shkurtër e autorit.
- Faqe 4: Gravurë – Trinia e Shenjtë.
- Faqe 5-11: Alfabeti greqisht me rregullat e leximit.
- Faqe 10-11: Ushtrime leximi greqisht.
- Faqe 12: Gravurë – Virgjëresha perëndilemë më të birin.
- Faqe 13-59: Fjalori trigjuhësh në tri kolona: greqisht – arumanisht – shqip.
- Faqe 59: Gravurë – Tog engjëjsh.
- Faqe 60: Gravurë – Kumti i engjëllit Gabriel.
- Faqe 61: Tekst greqisht – Lutje për Virgjëreshën.
- Faqe 62-67: Tekste greqisht – Shprehje të përzgjedhura nga Bibla dhe histori kishtare.

<sup>21</sup> Përktimi shqip i titullit: “Përvoja të para, hartuar prej shumë të diturit dhe shumë të devotshmit predikues dhe kryepriest, zotit Theodhor Anastas Kavalioti nga Voskopoja, dhe tashmë për të parën herë nxjerrë në dritë me shpenzimet e shumë të nderuarit dhe shumë të dobishmit, zotit Gheorghe Tricupa (= Gjeorgje Trikupa), i mbiquajtur Cosmichi (= Kosmisqi) prej Voskopoje. Venedik 1770. Shtypshkronja Antonio Bartoli”.

- Faqe 68-79: Tekste greqisht – Shprehje të natyrës etike-dogmatike.
- Faqe 80: Tri gravura të vogla.
- Faqe 81-92: Tekste greqisht. Në faqen 92 është rrokur edhe Tropari i Pashkëve greqisht dhe arumanisht.
- Faqe 93-4: Tabela e numërorëve me initiale greqisht.
- Faqe 95: Tabela e numrave me shifra arabe.
- Faqe 96: Emrat e muajve dhe trekëndëshi i shumëzimit prej njësheve deri 100.000 milion.
- Faqe 97-104: Alfabeti latinisht me rregullat e leximit me shkronja greqisht.
- Shtojcë, faqe 1-8: “Bukvar” – Alfabeti sllav me rregullat e leximit me shkronja greqisht. Kjo pjesë shtojcë është shtypur në shtypshkronjën e epirotit Demetrios Theodosiou po në Venedik.

Deri sot njihen e ruhen fizikisht gjithë-gjithë katër ekzemplarë të botimit të parë (*editio princeps*), të shpërndarë në katër biblioteka të ndryshme të Europës:

- Oberlausitzischer Bibliothek der Wissenschaften në Görlitz/RFGJ (Sig.: Spk. VII 58)
- Württembergischer Landesbibliothek në Stuttgart/RFGJ (Sig.: Phil. Oct. 4612)
- Biblioteca Academiei de Stiințe din România në Bukuresht (Sig.: CVR 373)
- Narodna in univerzitetna knjižnica v Ljubljani në Slloveni.

Për përshkrimin e detajuar bibliografik dhe rrugëtimet që ka përjetuar secili syresh nga duart e njërit apo tjetrit studiues dhe antikuariat librash, derisa sa kanë mbërritur në bibliotekat e përmendura më lart, hyn dorëzanë studiuesi austriak Peyfuss (2008 85vv.), i cili na kumton gjithashtu që ndër katër ekzemplarët që njihen deri sot vetëm dy sosh në dy bibliotekat gjermane gjëlljnë në plotësinë e vet, ndërsa dy të tjerët kanë mungesa faqesh, deri edhe një fashikull të tërë.

Po ashtu, dy ekzemplarë kanë luajtur rol të veçantë qoftë në historikun e studimit të fjalorit trigjuhësh, qoftë në ribotimet e mëvonshme të tij, çështje këto që do t’u përkushtohemi në rubrikat në vazhdim:

### 1.2.2 Fjalori trigjuhësh: historiku i studimit dhe ribotimet

Libri mësimor i Kavalitit pati qasje në botën shkencore të kohës thujse menjëherë pas botimit të tij e kjo falë interesit që shfaq fillimisht për fjalorin e përfshirë në të historiani i njohur me origjinë suedeze Johann Thunmann (1746-1778), i cili kërkoi dhe gjeti te ky fjalor, sidomos

në pjesët e tij shqip dhe arumanisht, material gjuhësor që mendonte se i përshtatej tezës së vet mbi marrëdhëniet etnike-gjuhësore në Ballkanin antik. Falë kësaj teze, që përsiat bartësit e shqipes si pasardhës të drejt-përdrejtë të fiseve ilire në perëndim të Ballkanit, kundrejt bartësve të arumanishtes si vijues të fiseve të romanizuara trake në lindje të gadishullit, Thunmann-i ishte i pari që ndërmori ribotimin e kolonave arumanisht dhe shqip, duke zëvendësuar njëherësh kolonën e parë greqisht me gjegjësen latinisht të përkthyer po prej tij. Këtë punë paraprahe ai ia përshtati si pjesë e veçantë veprës së tij të njohur: *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker*, II. *Über die Geschichte und Sprache der Albaner und der Wlachen* (Leipzig 1774, f. 169-239).

Jehona që përjetoi vepra e Thunmann-it në rrethet intelektuale-shkencore në Perëndim orientoi shpejt vëmendjen e studiuesve të ndryshëm edhe te fjalësi trigjuhësh në të, duke shfrytëzuar gjegjësit shqip dhe arumanisht në varësi me interesat përkatëse. Kështu p.sh. Martin Leake (1814) u përqendrua sidomos në materialin e pjesës shqip<sup>22</sup>, ndërsa sllavisti dhe balkanologu i njohur slloven Franz Miklosich (1881/2) u mjaftua vetëm me ribotimin e pjesës arumanisht të këtij fjalori. Të dy këta studiues janë mbështetur në ribotimin e ndërmarrë prej Thunmann-it, gjë që do parë edhe si tregues i qartë ndaj rrallësisë në qarkullim të *editio princeps*, së paku përgjatë shek. XIX. Që botimi origjinal kishte humbur thuajse tërësisht gjurmët në shek. XX<sup>23</sup>, këtë e dëshmon po aq qartë ndërmarrja e studiuesit Harald Haarmann për ribotimin anastatik të veprës së Thunmann-it (1976), e cila ishte bërë ndërkohë po aq e rrallë. Te botimi i Thunmann-it janë mbështetur gjithashtu në ribotimet e këtij fjalori edhe filologët shqiptarë Ilo Mitkë Qafëzezi (1936/7) dhe prej tij edhe Kolë Ashta ([1979] 2018<sup>24</sup>).

Një rrugë të ngjashme ka përjetuar edhe një ekzemplar i dytë i *editio princeps* që sot ndodhet i depozituar në bibliotekën e Akademisë së Shkencave në Bukuresht, por që e ka pasur dikur në zotërim albanologu i njohur Gustav Meyer. Ai mëngoi të realizojë një botim të ri filologjik të fjalorit trigjuhësh me shpjegime të detajuara gjuhësore etimologjike sidomos për pjesën shqip në radhën e tij *Albanesische Studien*, IV. *Das griechisch-südrumänisch-albanesische-Wortverzeichnis des Kavalliotis, herausgegeben und erklärt.* (Wien 1895) Ndërsa ekzemplari i botimit burimor që zotëronte dikur Meyer-i i kishte humbur (përkohësisht) gjurmët<sup>24</sup>, botimi i Meyer-it shërbeu si material bazë për ribotimin e

<sup>22</sup> Me ndryshimet dhe përshtatjet përkatëse: hollësisht Lloshi 2006 69vv.

<sup>23</sup> Peyfuss (2008 87) aludon që *editio princeps* e shfrytëzuar prej Thunmann-it është me gjasë ekzemplari që ndodhet në Bibliotekën në Görlitz të RFGJ.

<sup>24</sup> Ky ekzemplar, që ruhet sot në Bibliotekën e Akademisë së Shkencave të Rumanisë në Bukuresht, mund të konsultohet ndërkohë si variant i digjitalizuar në disa rrjete sociale të internetit, shih <<http://vlahoi.net/vlahiki-glossa/protopeiria-kavallioti>>.

përsëritur filologjik-gjuhësor me autorësi studiuesin e mirënjohur gjerman Armin Hetzer (Hamburg 1981).

Ribotimi i fundit i fjalorit trigjuhësh ka për autor studiuesin Giōrgēs Exarchos (= Γιώργης Ήξαρχος, Αθήνα [2008] 2016), që është mbështetur pas gjase në ekzemplar (digjital ?) të Bukureshtit.

Së fundi le të përmendim edhe një listë me 697 fjalë greqisht të fjalorit që duhet të ndodhet në bibliotekën e manastirit Panteleimon në Malin Athos. Si autori i kësaj liste, ashtu edhe historiku i përfuturit të saj mbeten deri sot të panjohur, anipse kanë nxitur dikur përsiatjen se mos kemi të bëjmë këtu me një ekzemplar tjetër të *editio princeps*, në mos dorëshkrim autograf të Kavaliotit d.v.<sup>25</sup>

Në bashkëvajtje me qëllimin kryesor të punimit tonë, në të cilin syzohet riprodhimin diplomatik të fjalorit të Kavaliotit (1770), përkatësisht botimin kritik si tekst i përkujdesur i pjesës shqip në të, jemi të detyruar t'i rrëfëhemi lexuesit, se jemi përqendruar në punën tonë ekdotike me tekstin (De 2022) thjesht dhe vetëm në *editio princeps* që e disponojmë sot në disa burime: bibliotekat në Stuttgart (St), Görlitz (Görl.) dhe Bukuresht (ASR – via internet)<sup>26</sup>, e duke konsultuar sipas rastit ribotimet filologjike të Thunmann-it (Thu 1774), të Meyer-it (Me 1895), të Qafëzezit (Qa 1936/7), të Ashtës (Ash 2018<sup>2</sup>), të Haarmann-it (HA 1976), të Hetzer-it (He 1981)<sup>27</sup> dhe të Exarchos (Ήξ 2016). Nuk janë mbajtur parasysh botimet e Leak-ut (Le 1814), të pjesës arumanisht të Miklosich (Mi 1881/2) si edhe fjalësi i kopjuar i Beza-s (Be 1934) prej dorëshkrimit në Manastirin Panteleimon në Malin Athos (A ?), ndërsa një ribotim kritik i fjalorit, i ndërmarrë prej Pericle Papahagi (1909) rezulton të jetë joekzistent<sup>28</sup>.

Në stemën e mëposhtme kemi ndjekur me plotësime të rastit gjegjësen e skicuar më parë prej Hetzer-it (1983 101):

---

Rrugëtimin e këtij ekzemplari e rindërton me hollësi Peyfuss 2008 85, 88.


<sup>25</sup> Hollësisht Peyfuss 1989 53, shën. 46, 47.

<sup>26</sup> Nuk kemi pasur mundësi të konsultojmë ekzemplar (që gjendet në bibliotekën e universitetit në Ljubljana (NUK)).

<sup>27</sup> Po ashtu, nuk kemi mundur të verifikojmë dot një ribotim të kësaj veprë në vitin 1998.

<sup>28</sup> Shih së fundi Peyfuss 2008 87, ndërsa Hetzer (1983 101) vendos me të drejtë shenjën e pikëpyetjes për një botim të tillë, që nuk ekziston. Referimi bibliografik i Papahagi-t (1909: *Scriitori aromânî în secolul XVIII*, Bucarest) nga ana e Peyfuss-it rezulton të mos jetë i saktë, meqë aty shqyrtohen në fakt krahas Ucuta-as, Dhanil-it edhe Kavalioti, veçse për autorin e fundit nuk ngjerojmë në libër asnjë ilustrim me faksimile e jo më edhe tejkshkrim prej veprës së tij Πρωτοπειρία.





Legjenda:

- Vijë drejtvizore: ribotime të mbështetura në burimin e parë të njohur.
- Vijë e ndërprerë me shigjetë: ribotime të mbajtura parasysh në punën ekdotike me tekstin.
- Vijë e ndërprerë pa shigjetë: marrëdhënie të hamendësuar pa forcë argumenti.

### 1.3 Fjalësi shqip në fjalorin trigjuhësh të Kavalitit

Fjalësi shqip, në të cilin jemi fokusuar sidomos në edicionin tonë kritik, është përbërës i fjalorit trigjuhësh në tekstin shkollor të Kavalitit (f. 13-59) që ngërthen si i tillë pjesën e tij të parë, e konceptuar kjo si fazë e përvetësimit paraprak të greqishtes si gjuhë komunikimi në shkollë për rishtarë të dy bashkësive të tjera gjuhësore-etnike, ato arumune dhe shqiptare. Autori përzgjedh për këtë model ligjërimin e thjeshtë në secilën gjuhë, duke synuar njëherësh sendërtimin e një koncepti të mirëfilltë pedagogjik. E ndërsa kjo përzgjedhje për gjuhë të tilla me lëvrime të mangët si arumanishtja dhe shqipja ishte si të thuash pa opsion alternativ, përzgjedhja e greqishtes popullore, përkatësisht e formës së saj në ligjërimin bisedor i shkon enkas përshtat konceptit didaktik të tekstit shkollor në vetvete, më saktë të lëndëve të ndryshme që synonin formimin e mirëfilltë humanist dhe atë teologjik ortodoks në shkollat greke të kohës.

Parë nga kjo perspektivë, nuk kemi përse bëjmë aspak çudi që vetë fjalori trigjuhësh është organizuar në formën klasike të një fjalori shumëgjuhësh, ku fjalët a lemat e izoluara në secilën gjuhë vijnë e përqasen me njëra-tjetrën për t'u mësuar më pas përmendësh prej nxënësve në mënyrë individuale ase në kor gjatë orëve të mësimi (si p.sh. glosarët dygjuhësh në Kodikun Beratas, gjysma e dytë e shek.

XVIII, f. 75-76; 87-102<sup>29</sup>). Prashtu ata mbarështonin gjithëherë si të tillë përvetësimin e greqishtes si gjuhë komunikimi në shkollë, sikurse ndiqnin me konsekuencë një vizion afatgjatë siç ishte zotërimi i saj si *lingua franca* në marrëdhëniet sociale-ekonomike jashtë bashkësisë e më tej si gjuhë prestigji kulturor-intelektual që mundësonte e vetme formimin humanist dhe teologjik, përkatësisht përqafimin e natyrshëm dhe me bindje të helenizmit sikurse edhe të besimit ortodoks bizantin si shkallët më të larta të qytetërimit universal dhe të besimit kristian njëherësh. Asgjëmangut, edhe lemat shqip në këtë fjalor janë rrokur e realizuar si pjesë e këtij modeli didaktik, duke përcjellë kështu shqipen e folur në ambientet ortodokse të kohës, anipse nuk jemi larg së vërtetës po të pohojmë rishtas që Kavalioti duhet të ketë qenë njohës dhe zotëruar i shqipes, por jo patjetër folës nativ i saj.

Pa dashur të hyjmë në analiza të mirëfillta leksiko-semantike, sikurse sosh variacionale-diatopike, le të mjaftohemi fillimisht me referencat e disa studimeve solide të ndërmarra në këtë drejtim prej dy studiuesve filologë të kohës, siç janë Armin Hetzer (1981, 1983) dhe më vonë edhe Xhevat Lloshi (2006 63vv.; 2018 193vv.). Të dy kanë vënë në dukje krakteristikat kryesore të fjalësit shqip, të cilat lejojnë, ndër të tjera, që ai:

- të sistematizohet sipas fushave të ndryshme të leksikut, në varësi këto edhe me funksionin didaktik-mësimor,
- të vëzhgohet në përqasje me gjejëset greqisht dhe arumanisht sa i përket spektrit semantik në përdorim, bashkëpërkimit në përkthim, si edhe
- të shqyrtohet përhapja e tij dialektore për periudhën në fjalë, duke i dhënë përgjigje njëherësh edhe pyetjes, se përse ndeshim te ky fjalës aq shumë njësi leksikore që u takojnë të folmeve të gegnishtes, përkatësisht grupit të folmeve geqe të Shqipërisë së Mesme.

Ndërsa për dy çështjet e para të dy këta studiues përshkojnë thujtë të njëjtën hulli – sigurisht duke shtuar dhe plotësuar këtu njëri-tjetrin –, lidhur me çështjen e tretë është mirë të bëhet ndonjë sqarim a saktësim i rastit. Kështu, Hetzer-i (1981 26), sa i përket fjalësit shqip në fjalorin e Kavaliotit, mëton ngulitjen e një forme gjuhësore mbidialektore në bashkësinë ortodokse shqiptare si shtresë e veçantë sociale, në të cilën ishin rrokur në mënyrë qoftë edhe sporadike elemente gegë<sup>30</sup>.

<sup>29</sup> Një koncept më të avancuar didaktik ka zbatuar tri dekada më vonë nxënësi i tij, Mjeshtër Dhanili (1802), i cili vendos në kolona përballë njëri-tjetrit tekste të shkurtra e të thjeshta në greqisht, arumanisht, bullgarisht dhe shqip. Shih Demiraj 2022a 24v.

<sup>30</sup> Lejohemi të përmendim me këtë rast edhe mendimin e Desnickajas (1987, 285), sipas së cilës në leksikun shqip të Kavaliotit kemi një shqipe popullore që përfaqëson koinenë bisedore jugore të krijuar mbi një bazë popullore më të gjerë. Shih edhe Lloshi 2008 65.

Ndryshe përsiat Lloshi (2008 68v.), për të cilin: “Konceptimi i sotëm gjeografik, fetar e gjuhësor i Shqipërisë së Jugut nuk përputhet me realitetin e trevave shqiptare në shekullin XVIII...” dhe se: “...për njerëz si Kavalioti zona e ortodoksëve që flisnin shqip përfshinte një hapësirë të pandërprerë nga Durrësi e Elbasani në veri dhe deri te Follorina e Janina në Jug”, e nga ana tjetër: “...për arumunët dygjuhësh nuk ishte e perceptueshme si sot ndarja dialektore ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes, pa ripërmendur faktin se vetë dallimet dialektore nuk ishin në fazën e mëpastajme të zhvillimit.” Prashtu, sipas Lloshit (2008 f. 69), lidhur me gegizmat që shfaqen te fjalësi shqip i Kavaliotit nuk bëhet assesi fjalë për “një përzierje artificiale të tipareve dialektore ose amalgamë, por një proces evoluimi...”, që ka “...një vazhde të qartë të një tradite të shkruar mbi bazën e gegërishtes së mesme.”

Nga sa përmblodhëm thukët më lart, mund të kumtojmë paraprakisht që trashëgimia e hershme e shkrimit shqip (me alfabet greqisht) në Arealin Kulturor ortodoks të Jugut nuk është aq e pasur, sa të mund të mbështesë me forcë argumenti pozitiv njërin apo tjetrin gjykim të njërit apo tjetrit studiues. Për më tepër, do mbajtur parasysh se në rastin konkret nuk disponojmë assesi një tekst të lidhur e të rrjedhshëm, por thjesht dhe vetëm një fjalës shqip me rreth 1125 njësi leksikore<sup>31</sup>, të cilat në rastin më të mirë mund të ishin në qarkullim atëbotë edhe në Voskopojë, si qendër e fuqishme urbane dhe arsimore që mbarështonte marrëdhënie intensive ekonomike-tregtare dhe institucionale-kishtarë (si pjesë e Patriarkatit të Ohrit) me qendra të ndryshme, qofshin këto në zonat më veriore toske (Berat, Ardenicë etj.), ashtu edhe në ato jugore gege (Elbasan, Shijon, Durrës etj.). Gjithsesi, kjo situatë gjuhësore rezulton të jetë unike në kulturën e shkrimit shqip me alfabet greqisht e si e tillë mund të kundrohet fare mirë edhe si produkt unikat i një autori të veçantë, siç është në këtë rast Kavalioti d.v. si autori i fjalorit<sup>32</sup>.

Parë nga kjo perspektivë, kërkesë e dorës së parë jet dhe mbetet shqyrtimi në veçanti i gjithë atyre gegizmave që shfaqen në fjalësin e Kavaliotit, një detyrë kjo që jemi përpjekur ta mbajmë deri diku parasysh në vëzhgimet kritike të natyrës gjuhësore-filologjike si rubrikë e veçantë që shoqëron riprodhimin diplomatik të fjalorit së bashku me edicionin kritik të fjalësit shqip në të. (§4.1)

<sup>31</sup> Për Hetzer-in (1981 56) kemi në fjalor 1137 lema shqip nga 1170 greqisht që janë të regjistruara në fjalor.

<sup>32</sup> Përzierje të tilla të natyrës variacionale-diatopike nuk shfaqen më gjëkund në tekstet shqip me alfabet greqisht, si psh. në Kodikun Beratas (Demiraj 2019a) e në atë të Kostë Cepi – Vithkuqarit (Demiraj 2020b), ose në fjalorët e mëvonshëm dy- e katërgjuhësh, si p.sh. po në Kodikun Beratas ose në fjalorin e Dhanil Voskopojarit (Demiraj 2022a).

## 2 Kodi alfabetik dhe rregullat e leximit të tekstit shqip

Një vëzhgim sado i përciptë i fjalësit shqip të rrokur në fjalor lejon t'i bashkohemi pa hezitim aradhes së studiuesve filologë që janë marrë deri sot me përshkrimin e librit mësimor të Kavalitit, përkatësisht me interpretimin dhe botimin kritik (edhe) të materialit shqip në atë fjalor (sidomos Hetzer 1981, 1983). Këta mëtojnë me të drejtë se sistemi grafik në pasqyrimin e atij materiali përcjell mirëfilli atë traditë dhe variacion në kulturën e shkrimit shqip me alfabet greqisht që mbizotëron në botimet dhe dorëshkrimet poliglote të kohës me destinacion Arealin Kulturor ortodoks të Jugut (Terpo 1731; Kodiku Beratas në shek. XVIII, më pas Dhanili 1802, Kostë Cepi – Voskopojari 1822/23 etj.). Kjo vijimësi në kulturën e shkrimit shqip sendërtohet në këtë fjalës si në njohjen dhe përvetësimin e kodit alfabetik, ashtu edhe në zbatimin në përgjithësi të të njëjtit aparat ortografik që përdornin atëbotë autorët shqip- dhe arumanishtfolës në arealin në fjalë. Madje nuk mungon edhe ndonjë studiues në kohën tonë që vëren këso rasash shkrimit e arumanishtes me këtë alfabet në rolin e katalizatorit që sheshon vështirësi të rastit lidhur me sistemin grafik dhe rregullat e leximit të fjalësit shqip (Lloshi 2008 273vv.).

Le të ndalemi paraprakisht në pasqyrën e kodit alfabetik dhe të aparatit ortografik të zbatuar në fjalësin shqip, bashkë ashtu siç kemi mundur ta qëmtojmë dhe klasifikojmë gjatë punës për digjitalizimin e faksimileve të botimit të parë (Venedik 1770).

Tabela e mëposhtme përcjell në mënyrë pak a shumë të sistematizuar fondin e grafemave me kombinimet e tyre në kod (kol. III: KAP = KAvalioti – Πρωτοπειρία) së bashku me vlerat fonetike (kol. I: IPA = International Phonetic Alphabet) dhe shembujt përkatës në tekst (kol. IV). Për një orientim më të mirë në lexim vlen sigurisht edhe përqasja me listën e grafemave gjegjëse në alfabetin e Manastirit (kol. II: MAN = Alfabeti i MANastirit si alfabeti i shqipes së sotme standarde), si vijon:

Tabela 1: Kodi alfabetik me vlerat tingullore-funksionale

| IPA  | MAN | KAP     | Shembuj KAP                                                                                                               |
|------|-----|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| [a]  | A   | α       | άνα [ánə], ντούα [dúə], διάμα [ðjámə], μάρ [bar]                                                                          |
| [b]  | b   | μπ<br>π | μπόστ [boʃt], μπλιούαμ [blúam], σκούμπα [ʃkúmbə], δάμπ [ðəmb] πλιούαγ [blúaj]                                             |
| [ts] | c   | τζ      | κρασταβέτζ [krastavéc], κατζέκ [katsék], νεμέτζ [neméts]                                                                  |
| [tʃ] | ç   | τς      | τζαλασσίσιγ [tʃaləstíjə], αλτζί [altʃi], χαρτζιάσ [hərtʃás]                                                               |
| [d]  | d   | ντ<br>τ | ντάρδα [dárðə], φούνντ [fund], η ντρέϊτα [i dréjtə]<br>η σατόσιμ [i sadóʃim], τιάλ [djal], τιάθτα [djáθtə], τρέτζ [dretʃ] |

|       |    |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                          |
|-------|----|---------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| [ð]   | dh | ð                               | δέλπαρ [ðélpəɾə], κούδαρ [kúðəɾə], δπόγ [ðboj]                                                                                                                                                                                                           |
| [e]   | e  | ε<br>αι                         | εδέ [edé], χέρδε [héɾde], βέ [ve], νεμέτς [neméts]<br>γιάιτ [jéto], γκαί [je], δαί [ðe], φαινέρ [fenér]                                                                                                                                                  |
| [ə]   | ě  | α<br>*ε<br>(α)                  | λιόπα [lópa], η τάρ [i tərə], λάμα [lámə]<br>κάλε [kálə], Έγγελ [éŋɛl]<br>(η άμμπλια [i əmbliə], δάμμπ [ðəmb], λιάμσσ [ləmʃ])                                                                                                                            |
| [f]   | f  | φ<br>υ                          | καλάφ [kələf], φιάλια [fiála]<br>καμηλαύκ [kamiláfɤk]                                                                                                                                                                                                    |
| [g]   | g  | γκ<br>*γ                        | γκρέπ [gɾep], η έγκαρ [i éɣər], γκορέν [goɾén], γκρούα [grúa]<br>λιουγάτ [liugátə], μαργαριτάρ [margarítar]                                                                                                                                              |
| [j]   | gj | γκ<br>γκι-A/E<br>γ(γ)ι          | χίτζγκε [hítʃɛ], γκέλα [jélə]<br>γκιάκ [jak], γκιάλπα [jálpə], γκιού [ju], γκιέπ [jemɐ]<br>γγιλπάρα [jilpəɾə], νταγγιόι [dajóji], γγέρπ [jeɾp], αργιάντ [arɣjənt]                                                                                        |
| [h]   | h  | χ                               | χαρόγ [haróɟ], ντίχ [ndih], όχτηκ [óhtik]                                                                                                                                                                                                                |
| [i]   | i  | ι<br>υ<br>η<br>*ει              | πίσσα [písə], μπιλμπίλ [bilbíl], μιέλ [miel], νίπ [nip], μπρί [brí]<br>τύ [ti], κολύμπε [kolíbe], ρρύλα [ríla], μύ [mi]<br>η τάρ [i tərə], γκατή [gati], λίρ [lir], κανδήλε [kandíle], η ζή<br>[ i zi]<br>κειρί [ciri], λείνι [lípsjə], κειλί [cili] (?) |
| [□/j] | j  | γι<br>γ#<br>*γγ#<br>ĩ<br>ι<br>η | μπαγάμε [bajáme], κρίπγια [kírjə], γιαίτ [jéto]<br>παγκαζόγ [pagəzój], ζιέγ [ziéj]<br>*μπίγγ [mpij]<br>φαϊκούα [fajkúa], φάι [faj], σόι [soj], νταγγιόι [dajóji]<br>ριέπ [ɾjep], μιέκαρ [mjékaɾə],<br>η σστρέητ [i ʃtréjto]                              |
| [k]   | k  | κ<br>κκ                         | καρκαλέτς [karkaléts], κά [ka], λιάκ [lak]<br>φίκκ [fik] (?), σπανάκκ [spanák] (?)                                                                                                                                                                       |
| [l]   | l  | λ-E/C/#<br>λι-A/E<br>λλ         | λιούεγ [lýej], μπιλμπίλ [bilbíl], κάλε [kálə], λέχ [leh]<br>πλιούαρ [plúar], λιέ [le], λιούνντρα [lúndɾə], τλ μπλιέμ [tə blem]<br>ηλλίκ [i lik], μάλλι [máli], πλλήσ [plis], φύλλ [fil]                                                                  |
| [l]   | ll | λ<br>*λλ                        | μιέλ [miel], σιέτουλα [sjétula], Λάρρα [láɾə], βαλά [valá]<br>κόλλα [kólə], ούλλ [yl], σούμπουλλ [súmbul], πιούλλ [pyl]                                                                                                                                  |
| [m]   | m  | μ                               | η μανούαμ [i mənúam], νάμας [náməs], ντάσμα [dásmə]                                                                                                                                                                                                      |
| [n]   | n  | ν                               | νίπ [nip], μουνντίμ [mundím]                                                                                                                                                                                                                             |
| [ɲ]   | ɲj | ν<br>ννι<br>νι                  | ννερί [ɲerí], φκίνν [fciɲ]<br>ννιόχ [ɲoh], φισσνιάρ [fiʃɲár], κασστέννια [kəʃténɲə]<br>ηγκαρμούνιουν [i ɣɛɾmúnɲun]                                                                                                                                       |
| [o]   | o  | ο<br>ω                          | νοβόγια [ɲonójə], ομπόρ [obór], γκομάρ [gomár]<br>πώ [po], Ζώτ [zot], σώς [sos], λεχών [lehón]                                                                                                                                                           |
| [p]   | p  | π                               | πούλπα [púlpa], τράπ [trap], πουρτέκα [purtékə], λαπίγ [lapíj]                                                                                                                                                                                           |
| [c]   | q  | κ-E<br>κι/ι<br>*κκ(ι)           | κυρά [ciɾá], φκίνν [fciɲ], κίσσα [císə], κινδύν [cindín], κιοútς [cytʃ]<br>παλκιέγ [pəlciéj], κιέγκε [céɲje], κιούμασστ [cúmaʃt], σκιάς [ʃcas]<br>κκιέλ [ciel], σιαλιαβρίκκ [ʃalavɾic], πάκκι [pac], κριούκκ [kɾyc]                                      |

|        |      |                        |                                                                                                                                                                                       |
|--------|------|------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| [r]    | r    | ρ<br>*ρρ               | Έρρα [érə], μπουγιάρ [bujár], ούρα [úra]<br>αρρί [arí] (?), λάρρα [lára]                                                                                                              |
| [r]    | rr   | ρρ<br>ρ (?)            | κιέρρε [qére], ζόρρα [zóra], ντέρρ [der], ντέρρ [der]<br>Ρέζε [réze], ντέρ [der] (m.)                                                                                                 |
| [s]    | s    | σ                      | αρνίς [arnís], νίσγια [nísja], νέσαρ [nésar], σίσα [sisə]                                                                                                                             |
| [ʃ]    | sh   | σ<br>σι<br>σσ<br>σσι-Α | η σατόσιμ [i sadóʃim], σκρεπατίγ [ʃkrepətíj], σπατόγ [ʃpátój]<br>σιούρ [ʃur], σιαλιαβρίκκ [ʃalavric]<br>βρέσστα [vréstə], μάσσκουλ [máʃkul], βέσς [veʃ]<br>σσιόχ [ʃoh], Σσιέντ [ʃent] |
| [t]    | t    | τ<br>*ττ               | τιέταρ [tjétar], η μπούτα [búta]<br>βαρτιέττα [vartétja]                                                                                                                              |
| [θ]    | th   | θ                      | η μάθ [i math]                                                                                                                                                                        |
| [u]    | u    | υ = ου                 | μπούρα [búra], νούμουρ [númur], μπούσσ [mbuʃ]                                                                                                                                         |
| [v]    | v    | β                      | βαλά [valá], χαβά [havá], βά [və]                                                                                                                                                     |
| [dz]   | x    | τζ                     | τζιντζίφε [dzindzife]                                                                                                                                                                 |
| [(dʒ)] | (xh) | τζ                     | Γκαντζίτεμ [gandzíte] (?)                                                                                                                                                             |
| [y]    | y    | ιΐου<br>*ου            | μιουτί [mytí], αϊού [aý], μιουχιούρ [myhýr]<br>ούλλ [yʎ] (?)                                                                                                                          |
| [z]    | z    | ζ                      | η ζμπράζατ [zbrázət], η ζότι [zóti], νόζε [vóza], η σβέσσατ [i<br>zvésət]                                                                                                             |
| [ʒ]    | zh   | ζζι<br>ζζ<br>ζ         | ζζάμπα [zába], πρέζζια [mrézə]<br>μπαζζινταρλόκ [bazdarlók], λαβόζζγκα [ləvózza], μιουζζντέ<br>[myzdé]<br>βιζγκίμ [vizgím]                                                            |
| [ks]   | ks   | ξ                      | διδάξ [ðiðáks], πεξιμάθ [peksimáθ], παξέλλ [paksél], ταξίθ<br>[taksiθ]                                                                                                                |
| [mb]   | mb   | μ(μ)π<br>*π            | μάγ [mbaj], μπράμα [mbrámə], σκούμπα [ʃkúmbə]<br>γκιέπ [jemb]                                                                                                                         |
|        | mp   | *μπ                    | μπίγγ [mpij]                                                                                                                                                                          |
| [nd]   | nd   | ντ                     | κουντρέ [kundré], η ντιούρα [i ndýra], ντίχ [ndih]                                                                                                                                    |
| [ng]   | ng   | γκ                     | γκαντάλε [ngadále], γκέ [nge]                                                                                                                                                         |
| [nj]   | ngj  | γγ                     | έγγελ [énjeʎ], ούγγι [únji], φαγγίλ [fənjíl]                                                                                                                                          |
| [ps]   | ps   | ψ                      | αψίθ [apsíth], στύψ [stips], χάψ [haps]                                                                                                                                               |

## 2.1 Sqarime të rastit

Tabela e mësipërme nuk mëton një ezaurim të plotë, sidomos të bashkëlidhjes së shkronjave dhe/ose grafemave në varg, që ndikon në një rast a një tjetër rregullat e leximit të rrjedhshëm në fjalësin shqip. Gjithashtu, për arsye më fort teknike, nuk është rrokur në tabelë inventari i plotë i ligaturave greqisht, sikurse përdorimi i *jota subscriptum* dhe i *hyphen*, që shënojnë shqiptimin e lidhur në një



numër togtingujsh me rregullat fonotaktike përkatëse, bash ashtu siç jemi përpjekur t'i përcjellim me besnikëri në riprodhimin diplomatik të fjalorit. Tabela i mundëson gjithsesi lexuesit të njohë nga afër dhe në mënyrë të sistematizuar inventarin e grafemave me tiparet e tyre kryesore nyjëtimore si edhe atë variacion grafik brenda kodit alfabetik që ofron si i tillë fjalësi shqip qoftë në vetvete ashtu edhe në përfaqje me traditën e vyer të shkrimit shqip me alfabet greqisht në Arealin Kulturor ortodoks të Jugut në shek. XVIII-XIX, p.sh. Dhanili 1802 si nxënës i Kavaliotit d.v. Prashtu vëmë oroe ndër të tjera, që:

- a. Fondi i shkronjave dhe i varianteve grafike të përdorura si të tilla në tërë tekstin, bazohet fund e krye në alfabetin greqishtes me gjithë-gjithë 24 shkronja, khs.: < α β/β γ δ ε ζ η θ ι κ λ μ ν ξ ο π ρ σ τ υ φ χ ψ ω >. Përdorimi i tyre (edhe) në tekstin shqip kushtëzohet në përgjithësi me shqiptimin, përkatësisht rregullat e leximit të tyre në greqishte, khs. ndër të tjera edhe zanoret: [i] = /i/ = <η ι υ \*ε ι> dhe [o] = /o/ = <ο ω>; dysitë fonemike: [ks] = /ks/ = <ξ> dhe [ps] = /ps/ (pranë /psh/) = <ψ>; sikurse edhe ligaturat me vlerë fonemike të stabilizuar qysh në greqishten kishtare dhe atë të kohës, khs.: <ζ = στ> = [st] = /st/ (pranë /sht/); <ϝ = ου> = [u] = /u/ (khs. Terpo 1731, Dhanili 1802 etj.).
- b. Zgjidhje të tjera grafike që Kavalioti i ka marrë të gatshme prej kodit grafik të greqishtes, përkatësisht prej traditës së shkrimit shqip me alfabet greqisht, rezultojnë të mos kenë qenë gjithherë fatlume, meqë mundësojnë lexime ambigue. Këtë rrethanë e ndeshim në mënyrë të përsëritur në pasqyrimin grafik të mbylltoreve të zëshme /b d/, që në shkrimet shqip të kohës realizohen edhe me njëshkronjëshat <π τ> krahas digrafeve <μ π ν τ>, por që në tekstin shqip i lexojmë sipas rastit edhe si togje bashkëtingëlloresh /mb mp nd nt/. Gjithsesi si në këtë rast, ashtu edhe në raste të tjera që lidhen me leximin korrekt të tekstit e kemi shumë më të vështirë me përsiatur variacione reale në ligjërimin e thjeshtë të asaj kohe, përkatësisht në mënyrën e përjetimit të tyre prej autorit joshqipfolës të vetë fjalorit.
- c. Një rrethanë të tillë, për ne sot krejt të pazakonshme, paraqet edhe leximi i rregullt i grafemës gr. <δ> si [ð] edhe për njësi leksikore *dëboj*, *dboj* si shq. *dhboj* = δπόγ [ðboj]. Këso rasash – edhe pse jo pa vrasamendje<sup>33</sup> – nuk kemi ndërhyrë në tekst, duke menduar se mund të jetë pjesë e variacionit gjuhësor në ligjërimin popullor të fqinjët arumunë (?).

<sup>33</sup> Kolegia Anila Omari (mail: 9 shtator 2022) përsiat në këtë rast edhe një shqiptim të mundshëm të mbylltores së zëshme dhëmbore [d], krahas asaj frikative gjegjëse [ð].

- d. Vështirësi jo të paka shoqërojnë leximin e rrjedhshëm të tekstit shqip edhe funksioni bi-deri polivalent i disa grafemave të thjeshta dhe/ose të përbëra, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me rregullat (orto)grafike të greqishtes së kohës. Siç i kemi fiksuar edhe në vendet përkatëse në tabelë, dysi leximi lejon p.sh. përdorimi i disa grafemave bashkëtingëllore, si p.sh.: <π> për /p ~ b ~ mb/, <τ> për /t ~ d/, <σ σσ> për /s ~ sh/, <τζ> për /c ~ x ~ ç ~ xh/ etj.
- e. Asgjëmangut një numër aspak i vogël problemesh ortografike ka të bëjë edhe me do tinguj me funksion kuptimdalues (fonema) të shqipes së kohës që janë të huaj në sistemin fonetik të greqishtes: khs. /ë y ll rr/ = [ə y ɫ r]. Pikërisht në këto raste përjetojmë në lexim ndërhyrjet e vetëdijshme të Kavalitotit, i cili përdor disa përvoja zgjidhjesh grafike në kod që nuk janë gjithnjë fatlume.
- Përdorimi i shkronjave <ι/η> si mjet grafik për të shmangur leximin e gabuar në ato raste kur shqiptimeve alofonike të së njëjtës fonemë në greqishte i përgjigjen në shqipe dy tinguj të ndryshëm me funksion kuptimdalues (fonema), khs. shq. /k ~ q/ = [k ~ c] = <κ-A> vs. <κι/η> = [k ~ c], ndërsa proporcione të paqëlluara i hasim në dysitë e fonemave shq. /g ~ gj/ e /n ~ nj/ kundrejt gjegjëseve alofonike gr. <γ-A ~ γ-E> = /g/, <v-A ~ v-E> = /n/ (sh. në tabelë, sikurse Demiraj 2022a 30).
  - Si mjet grafik nuk mund të vlerësojmë gjithherë dyfishimin e shkronjave (<λ(ι) q> (/l r/ ~) <λλ q q> për shq. /ll rr/, d.m.th. për dy tinguj të tjerë rezonantë me funksion kuptimdalues që nuk njihen si të tillë në greqishte. (sh. edhe Demiraj 2022a 30)
  - Për përdorimin e *jota subscriptum* si mjet grafik sh. poshtë pikën g.
  - Për përdorimin e *hyphen* si mjet grafik sh. poshtë pikën j.
- f. Zanorja /e/ paraqitet grafikisht rregullisht me *epsilon* <ε> dhe në raste sporadike edhe me digrafin <α>; sh. poshtë pikën g.
- g. Paraqitja grafike të fonemës zanore /ë/ si fonemë pa gjegjëse në greqishte, është sigurisht më e larmishmja meqë ka frekuencë të lartë dhe nyjetim të variueshëm. Rrethana të paraqitjes së saj grafike pritej megjithatë të mos ishin aq të komplikuar meqë në arumanishte kjo zanore nuk është aspak e huaj. Kështu që lejohemi të sistematizojmë paraqitjen e saj grafike si vijon:
- <α>: Shkrimi i saj me shkronjën *alfa* dhe *jota subscriptum* si mjet grafik është i rregullt në tekst, sikurse edhe në Kodikun Beratas (Demiraj 2019a 41) dhe më pas në fjalorin e Dhanilit (Demiraj 2022a 31).
  - <α>: Jo rrallë ndeshim në fjalësin shqip vetëm *alfa* të thjeshtë, pikërisht aty ku pritet të kemi zanoren qendrore

/ë/. Asgjëmangut kemi të bëjmë me harresa të rastit, qoftë prej autorit në dorëshkrim, qoftë prej radhitësit të tekstit në shtypshkronjë. Pra këto rasa nuk duhen parë patjetër si gegizma shtesë në glosarin e Kavalitit. Lajthitje të kësaj natyre i përjetojmë sot e gjithë ditën me shkrimin e pakontrolluar të grafemës <ë> pa *tremë* në shqipen letrare.

- <ε>: Në shumë raste ndeshim në tekst edhe shkronjën *epsilon* (<ε>) aty ku pritet shkrimi me <α>: Denduria e përdorimit është e tillë sa që është vështirë të operohet me lajthitje në shkrim të autorit. Pas gjithë gjasash kemi të bëjmë – sikurse në rastin e Mjeshtër Dhanilit (Demiraj 2022a 31) – me një variacion zanor në ndërgjegjen gjuhësore të autorit, si arumanishtfolës i zonës, ku zanorja qendrore /ë/ = arum. <ă> ndërndërrohet shpesh me /e/ (Capidan 1929-30 171<sup>34</sup>) – Kjo rrethanë do të përcillet si e tillë në tejshkrimin e zgjeruar të fjalësit shqip.
  - <αι>: Në këtë kuadër do të veprohet edhe në ato rasa të paka në tekst ku na shfaqet digrafi <αι> = /e/.
  - Këto dhe raste të tjera të variacionit grafik dhe gjuhësor do të përcillen me shpjegimet përkatëse në rubrikën “Vëzhgime kritike” (§6.1) që përmbyll punën kryesore të studimit tonë lidhur me riprodhimin diplomatik dhe tejshkrimin e tekstit burimor.
- h. Shumësia e paraqitjes grafike të zanores /i/ në greqishte, shfrytëzohet rregullisht në tekst me shkronjat <ι, υ, η> dhe shumë më rrallë me <ει>.
  - i. Zanorja /y/ paraqitet rregullisht në tekst me trishkronjëshin <ιου>; rrallë (e kjo vetëm me argument interpretimi filologjik) edhe me <ου>.
  - j. Bashkëtingëllorja /j/ (= *glide*) pasqyrohet në tekst në disa mënyra <γι, ιγ, -(γ)γ, η, ι, υ> pa shpërndarje distribucionale grafike të dukshme. Situatë e ngjashme edhe te Dhanili 1802 (sh. Demiraj 2022a 32)
  - k. Në paraqitjen grafike të lëngëtores së thjeshtë /l/ vërehet deri diku një shpërndarje distribucionale: <λ-E/C> ~ <λι-A>, e në trup të fjalës në raste sporadike dyfishimi <λλ(ι)>. Situatë e ngjashme edhe te Dhanili 1802 (sh. Demiraj 2022a 32)
  - l. Lëngëtorja /ll/ është në të kundërtën grafikisht e paqëndrueshme: <λ, λλ> e kjo ka të bëjë jo vetëm me variacionin dialektor të shqipes në ato zona (si toskërishte verilindore), por edhe me ndjesinë gjuhësore të autorit si folës nativ i arumanishtes. Kjo situatë vërehet edhe në paraqitjen grafike të vibranteve /r/, /rr/, ku dyfishimi <qq>

<sup>34</sup> Sh. më poshtë edhe §6.1: 13 2.

vs. <q> ndërndërron vendet në mënyrë të parregullt. Situatë e ngjashme edhe te Dhanili 1802 (sh. Demiraj 2022a 32)

- m. Problematikë e ngjashme karakterizon edhe paraqitjen grafike të hundores /nj/, e cila në shumë raste kolidon me hundoren /n/: <\*v, \*v<sub>l</sub>, vv, vv<sub>l</sub>>. Ky problem në dukje i natyrës grafike ndërlikset a) në radhë të parë në ndërgjegjen gjuhësore të autorit, si folës nativ i arumanishtes, ku kjo fonemë (sikurse në greqishte) mungon, por b) do mbajtur parasysh edhe përvetësimi prej tij i variacionit dialektor të shqipes së trevave toske verilindore sidomos i atij në sistemin foljor, ku ndërndërrimet ndërmjet tingujve /j/ ~ /nj/ ~ /n/ brenda paradigmeve përkatëse herë-herë nuk lejojnë një hulumtim të patëmetë të realitetit gjuhësor të kohës në këto vise. Probleme të rastit, që jo gjithmonë përjetojnë zgjidhje fatlume, jemi rrekur t'i shqyrtojmë në veçanti në rubrikën "Vëzhgime kritike" (§4.1)
- n. <ç> = \*/-s/ nuk shfaqet asnjëherë në tekst me funksionin e saj zanafillës në pozicion fundor. Situatë e ngjashme edhe te Dhanili 1802 (sh. Demiraj 2022a 32)

Siç rezulton edhe nga kjo dorë vërejtjesh të thukëta të rreshtuara më lart, kodi alfabetik në tekstin shqip të fjalorit të Kavaliotit dëshmon një prirje të theksuar drejt shkrimit fonetik, i cili në kushtet e mungesës së një tradite të lëvruar mirë në kulturën e shkrimit shqip në këtë areal e rrit mjaft mundësinë e variacionit gjuhësor individual e që është shtjelluar në detaj në dy punime të mëparshme (Demiraj 2019a dhe 2022a), ku janë parashikuar përjasje sistematike me kodin alfabetik të përdorur në Kodikun Beratas dhe tek ai i nxënësit dhe patriotit të tij, Mjeshtër Dhanilit (1802).

Së fundi edhe dy fjalë për shenjat e pikësimit dhe rregullat ortografike në tekstin shqip të fjalorit trigjuhësh me autor Anastas Kavaliotin: Në inventarin e mjeteve grafike që përdor autori në tekst bën pjesë si shenjë pikësimi vetëm pika. Si ndikim i ortografisë së greqishtes do parë padyshim përdorimi i dendur i theksave, lloji dhe ndërndërrimi i shpeshtë i të cilëve (: *i mprehtë* ~ *i rëndë* ~ *majërrethor*) pas gjase nuk luan asnjë rol të natyrës fonetike ortografike në tekstet shqip, përpos dallimit të rrokjes së theksuar. Probleme aspak të vogla shoqërojnë në këtë rast edhe riprodhimin diplomatik të teksteve gjegjës greqisht e arumanisht, ku në shumësi rastesh është vendosur *ad hoc* përdorimi i njërit apo tjetrit theks. Siç kemi qartësuar edhe në vëzhgimet redaksionale lidhur me riprodhimin diplomatik të teksteve greqisht e shqip, nuk janë ndërmarrë në tejshkrim ndërhyrje masive redaksionale për fiksimin dhe përmirësimin e llojit të theksave, çka do ta shpërfytyronte të gjithë

tekstin origjinal<sup>35</sup>. Prashtu ecim të sigurt në atë hulli të hapur dhe përshkuar prej Meyer-it (1895) e të vijuar edhe prej Hetzer-it (1981), sa u përket premisave metodike në punën filologjike me tekstet shqipe me alfabet greqisht.

Në mbyllje vëmë në dukje edhe do probleme aspak të vogla, që shoqërojnë tekstin shqip, si shkrimi i fjalëve bashkë ose me ndarje të paqëlluara të njësive grafike, sidomos sosh të nyjshme. Lexuesi do të përditësohet lehtë me këtë rrethanë, në rast se shfleton edhe faksimilet e botimit origjinal me faqet përkatëse. Gjithsesi, vështirësitë e kësaj natyre janë të tilla që nuk i lënë patjetër dorë të lirë vullnetit të studiuesit me ndërhyrë arbitrarisht e në varësi me shkallën e njohjes dhe të ndërgjegjes gjuhësore.

## 2.2 Kodi alfabetik i Kavalitit në kulturën e shkrimit shqip

Një temë e veçantë studimi është hetimi i marrëdhënieve që jetin e gjëlljnë mes kodit alfabetik të Kavalitit me sosh të përdorur nga autorë të tjerë të hershëm në Arealin Kulturor ortodoks të Jugut. Sigurisht që në shqyrtim vijnë në radhë ata autorë që përdorin gjithashtu alfabetin greqisht me ose pa mjete grafike-diakritike e që plotësonin me të nevojat e një shkrimi fonetik-funksional të patëmetë për gjuhën shqipe. Prashtu pa dashur të hyjmë në detaje, lejohemi të kumtojmë konstatimin tonë paraprak, që autori i vetëm që i qëndron më pranë Kavalitit në këtë pikë është bash ish-nxënësi i tij, Mjeshtër Dhanili me fjalorin katërgjuhësh greqisht-arumanisht-maqedonisht-shqip (1802), veçse duke qenë botimi i tij i shtyrë në kohë me më shumë se 30 vjet, rezulton Mjeshtër Dhanili ta ketë përfituar të gatshtëm këtë kod alfabetik prej mësuesit të vet dhe jo e kundërta (Demiraj 2022a 26vv.). Ndonjë tjetër autor që i qëndron pranë na rezulton edhe njëri ndër autorët anonimë të mëvonshëm në Kodikun Beratas (gjysma e dytë e shek. XVIII), i cili ka kopjuar edhe rreth 100 njësi leksikore greqisht me gjejëset shqip prej fjalorit tij (Demiraj 2019a 171v.). Përndryshe shmangiet me autorë të mëhershëm si Nektar Terpo në Gravurën e Ardenicës (1731: Demiraj 2019c 31vv.) e të mëvonshëm si Kostë Cepi – Vithkuqari (1822/23: Demiraj 2018 105vv.) janë aq të dukshme, sa vështirë se lejojnë që të përsiasim një ecuri drejtvizore në marrëdhënien *trashëgimi* : *risi* në kulturën e hershme të shkrimit shqip me këtë alfabet në Arealin Kulturor të Jugut.

Parë nga kjo perspektivë, mendojmë se fiton gjithnjë e më shumë kuptim kumti i Çabejt, i përsëritur disa herë më lart, sipas të cilit: “Me Teodor Kavalitin fillon periudha e shkurtër e kulturës arumune në

<sup>35</sup> Këtë procedurë e ka ndërmarrë vetëm për tekstin burimor greqisht Exarchos (2016).



Shqipëri.” (1936 31), duke e kundruar kodin e tij alfabetik në radhë të parë si fryt i punës së tij për alfabetizimin e arumanishtes popullore, por që erdhi e ia përshtati atë edhe lëvrimit të shqipes. Saktësimet e mëtejshme të këtij qëndrimi i ngjetrojmë në një numër studimesh të Xhevat Lloshit, p.sh. së fundi më 2008 (303v.) kur merr në analizë kodin alfabetik të tekstit shqip në fjalorin e Mjeshtër Dhanilit, ku sipas tij: “Përfundimi më i rëndësishëm nga shqyrtimi i alfabetit të Dhanili është se ai gjithashtu ka ndërtuar një alfabet të përshtatur prej greqishtes për të shkruar arumanishten dhe pastaj këtë alfabet e ka përdorur edhe për bullgarishten, edhe për shqipen. Një e vërtetë kaq e qartë dhe e vetëkuptueshme është shpërfillur në studimet tona për një periudhë të gjatë vetëm e vetëm, sepse i është bërë bisht një të vërtetë tjetër po aq të qartë e të vetëkuptueshme: këta kanë qenë arumunë shqiptarë. Dëshiroj të përsëris fjalët e Eqrem Çabejt: “Me Teodor Kavaliotin fillon periudha e shkurtër e kulturës arumune në Shqipëri.””

Asgjëmangut kemi të bëjmë me një temë të patrajtuar deri sot sa e siç duhet në studimet tona filologjike e në të cilën edhe Lloshi kufizohet vetëm në konstatime të rastit. Prashtu është ndoshta më frutdhënëse për momentin, të analizojmë fjalorin e Kavaliotit thjesht si prurje të mëvetësishme, duke krijuar mundësinë e përqasjeve ballore në kulturën e shkrimit shqip me alfabet greqisht në studime të ardhshme.

Po ashtu mbetet për t’u hulumtuar edhe shqipja si e tillë në ndërgjegjen gjuhësore të autorit, çka lidhet qoftë me recepsionin ashtu edhe me nyjëtimin e fjalëve shqip prej autorit duke përsiatur sipas rastit mundësinë e ndikimit të rregullave fonotaktike të arumanishtes në përdorimin e shqipes si të tillë.

Këtë çështje që e kemi cekur kalimthi më lart në paraqitjen grafike të zanores qendrore [ə] (sh. tabelën §2 dhe §2.1/g) do ta rimarrim rast pas rasti në rubrikën “Vëzhgime kritike” që pason pjesën e riprodhimit diplomatik si edhe tejshkrimin e zgjeruar të fjalësit shqip me kodin e sotëm alfabetik të shqipes (§4.1).

### 3 Çështje të ribotimit të fjalorit

Ndërmarrja jonë për botimin kritik të materialit shqip në fjalorin trigjuhësh të Kavaliotit përkthehet dy faza pune që ndjekin dhe plotësojnë njëra-tjetrën:

1. Riprodhimi diplomatik i teksteve paralele greqisht, arumanisht dhe shqip me alfabet greqisht, duke mbajtur gjithherë parasysh faksimilet e botimit të vitit 1770 (§4: kol. I, II, III).
2. Kjo rrethanë e lehtëson punën në fazën e dytë për tejshkrimin e zgjeruar të tekstit shqip me kodin e sotëm alfabetik të shqipes (§4:



kol. IV) e që në njëfarë mënyre do parë edhe si botimi i përkujdesur filologjik si tekst i normalizuar dhe i përshtatur për një lexim të rrjedhshëm në një rreth shumë më të gjerë të interesuarish.

Ndërsa për rëndësinë e zbardhjes së tekstit greqisht (kol. I) në studimin tonë si tekst burimor nuk jemi të detyruar t'i përcjellim lexuesit argumente të rastit, për ngërthimin e tekstit arumanisht (kol. II) kemi ndërmarrë herë pas here e rast pas rasti ndërhyrje të tilla, duke e parë atë më se të domosdoshëm në përjasje ndër më të ndryshmet që kanë të bëjnë me punën filologjike me tekstin shqip, bash ashtu siç vërehet edhe në shumë e shumë vëzhgime kritike (§6.1) që shoqërojnë riprodhimin diplomatik dhe tejshkrimin e zgjeruar të tekstit shqip.

### **3.1 Riprodhimi diplomatik i fjalësit shqip**

Riprodhimi diplomatik si fazë e parë e ndërmarrjes tenton drejt një riprodhimi sa më të përpiktë të tekstit burimor në të tria gjuhët, pra nuk kemi ndërhyrë për përmirësime të rastit që mbështeten në normat e sotme ortografike, si p.sh.: segmentimi përkatësisht shkrimi bashkë apo ndaras i fjalëve, pjesëzave, nyjave dhe i shënjesve gramatikorë. Rrallë edhe me anotim (me kllapa katrore) janë bërë për arsye vendi zhvendosje të pjesshme të rreshtit duke vendosur një pjesë të strukturës grafike të një fjale nistore ase fundore një rresht më lart apo më poshtë. Janë përdorur gjithashtu edhe nënvizimi dhe kllapat katrore, sidomos për pjesën greqisht, kur kemi të bëjmë me shmangie, mungesa që shfaq botimi burimor, përkatësisht lexime të ndryshme prej varianteve të botuara ndërkohë prej Thunmann-it (1774), Meyer-it (1895), Qafëzezit (1936/7), Hetzer-it (1981) dhe Exarchos (2016).

### **3.2 Tejshkrimi i zgjeruar i fjalësit shqip**

Faza e dytë e punës sonë filologjike me tekstin origjinal rrudhet në tejshkrimin e zgjeruar të pjesës shqip (kol. IV), parë ky si edicion i përkujdesur kritik me kodin e sotëm alfabetik të shqipes. Sa i përket procesit të zëvendësimit të kodit alfabetik në tekstin origjinal me atë të shqipes së sotme letrare, realizimin e tij e mundësoi puna paraprake për zbërthimin e këtij kodi në tekstin origjinal, përkatësisht njohja dhe saktësimi i vlerave fonetike funksionale të tingujve që përcjell ky kod (sh. tabelën §2). Siç është vënë në dukje edhe në vëzhgimet redaksionale hyrëse që i bashkohen kësaj pjese (§§2.1-2.2), synimi ynë kryesor në këtë fazë pune ishte riprodhimi sa më i saktë i vetë tekstit origjinal me kodin alfabetik të shqipes së shkruar, pra me një sistem tjetër (orto) grafik, i cili mundëson leximin e tij të rrjedhshëm prej lexuesit të sotëm,

por që në të njëjtën kohë e ruan koloritin gjuhësor e stilistik të autorit.

Për t' i mundësuar lexuesit, qoftë ky edhe filolog specialist, përditësimin me tekstin origjinal dhe leximin e tij të rrjedhshëm, janë ndërmarrrë në tejshkrim do ndërhyrje që mbështeten në normën e sotme ortografike, gjithsesi duke u kufizuar këtu:

- a) në segmentimin e fjalëve, nyjave ose pjesëzave gramatikore të shkruara bashkë,
- b) në zbatimin pak a shumë të po kësaj norme lidhur me shkrimin e fjalëve me shkronjë të madhe.
- c) në markimin me nënvizim të variacionit grafik, që vështirëson leximin ose shkakton kolizion mes njësisht të ndryshme leksiko-gramatikore, të cilat sqarohen me shpjegimet përkatëse në aparatin filologjik (§4.1)

Ndonjë ndërhyrje tjetër e natyrës redaksionale dhe çështje gjithfarësh që lidhen me shqyrtimin dhe interpretimin e tekstit për nga perspektiva gjuhësore-filologjike janë rrokur po ashtu në rubrikën e zgjeruar “Vëzhgime kritike” (§4.1) që përmbyll dy fazat e para të punës me tekstin e me synimin largvajtës për të informuar lexuesin me detaje shtesë, duke rrokur këtu sipas rastit edhe të dhëna statistikore që tumirin njërën apo tjetrën ndërhyrje redaksionale në tekst.

#### 4 Provë riprodhimi diplomatik i fjalësive greqisht, arumanisht, shqip dhe tejshkrimi i gjegjësit shqip

| f. | Ρωμαϊκά                                                                                                                                                                          | Βλάχικα                                                                                                                                                                            | Αλβανικά                                                                                                                                                                               | Shqip                                                                                                                                      | rr.                                                              |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|
| 13 | Ἀββᾶς .<br>Ἀγάλια .<br>Ἀγαπῶ .<br>Ἄγγελος .<br>Ἀγγεῖον .<br>Ἀγγίστρι .<br>Ἀγελάδα .<br>Ἄγιος .<br>Ἀγκάθι .<br>Ἀγκάλη .<br>Ἀγκοῦρι .<br>Ἀγκῶνας .<br>Ἀγνάντια .<br>Ἀγορά .<br>... | Ηγούμενου .<br>Ανάργα .<br>Βόη .<br>Ἄγγελου .<br>Βάσου .<br>Γκρέπου .<br>Βάκα .<br>Σάμτου .<br>Σκίνου .<br>Μπράτζα .<br>Καστραβέτζου .<br>Κότου .<br>Καρσσί .<br>Κουμπάρε .<br>... | Ηγκουμέν .<br>Γκαντάλε .<br>Ντούα .<br>Έγγελ .<br>Ένα .<br>Γκρέπ .<br>Λιόπα .<br>Σσιέντ .<br>Γκιέ[μ]π .<br>Πουσστίμ .<br>Κρασταβέτζ .<br>Μπαλλίουλ .<br>Κουντρέ .<br>Ταμπλιέμ .<br>... | igumén<br>ngadále<br>dúa<br>éngjell<br>énë<br>grep<br>lópë<br>shent<br>gjemb<br>pushtím<br>krastavéc<br>bëljyl<br>kundré<br>të blem<br>... | 0001<br><br><br><br>0005<br><br><br><br>0010<br><br><br><br>0015 |

##### 4.1 Vëzhgime kritike

13 1 shq. <Ηγκουμέν> = *igumén* pranë arum. <Ηγούμενου> si përkthim i gr. <Ἀββᾶς>. Sipas Lloshit (2018 201) gjegjësjë greqisht

“përdoret vetëm për igumenin katolik, përndryshe shqip njihet si *abat*.”

- 13 2 shq. <Γκαντάλε> = *ngadále* për \**ngadálë*. Në materialin shqip na shfaqet jo rrallë grafema <ε> = [e] bash aso rasash kur pritej zanorja qendrore /ë/ = [ə]. Pas gjithë gjasash kemi të bëjmë këtu me një dukuri anase në të folmen arumune të autorit (varianti *fërshërot*), ku zanorja qendrore *ǣ* = [ə], falë një nyjëtimi variacional qiellzor, ndërron shpesh timbër si gjegjëse e zanores së përparme të ngritjes së mesme *e*. (Capidan 1929-30 171). Përderisa këtë dukuri e përjetojmë si specifike edhe në fjalorin katërgjuhësh të Mjeshtër Dhanilit (Demiraj 2022a 58, 51b), nuk e shohim të arsyeshme me ndërhyrë në tejshkrim (kol. Nr. 4), duke i mbetur kështu besnikë ndërgjegjes gjuhësore të Kavaliotit si *native speaker* i arumanishtes. M *gadale*, ndërsa H *ngadale*.
- 13 4 <Εγγελλ> = *éngjell* (H 177). Timbri i zanores së patheksuar gjen shpjegim njëlloj si në rastin më sipër: 13 2 *ngadále*.
- 13 8 <Σσιέντ> = *Shent* “Shën, Shenjt” (H 944), ndërsa M *shenjt*, *shënjt*. Vështirësi në fiksimin e tiparit të zëshmërisë së mbylltores fundore <-t>, e cila në bashkëlidhje me sonanten paraprijëse pritej të ishte po ashtu e zëshme. Në tekst vërejmë këso rasash lëkundje të natyrës grafike ndërmjet <-vτ#> dhe <-vvτ#>. Do t’i mbetemi besnikë kësaj rrethane grafike duke përcjellë në tejshkrim variacionin nyjëtimor gjegjës -nt# ~ -nd#.
- 13 9 <Γκιέπ> = *gjemb* (?), M *gjep*, *gjemb*, ndërsa H 283 *gjep*. I vetmi rast në tekst kur grafema fundore <-π> – sipas ndërgjegjes së sotme gjuhësore – përfaqëson sekuencën tingullore -mb. Kjo rrethanë na lejon të përsiasim se mos kemi të bëjmë me një harresë të autorit në dorëshkrim, në mos një lajthitje gjatë procesit të shtypit: \*\*<Γκιέμπ>.
- 13 12 <Μπαλλίουλ> = *bëlyl* “bërryl”, ndërsa M *bëlyl* dhe H 52 *bëlyll*. Pas gjase një fjalëformë me asimilim regresiv e në distancë për bashkëtingëlloren e lëngët: \*...r...l... → ...l...l... Sipas Lloshit (2018 201) një trajtë e gabuar “që mund ta jepte vetëm dikush, i cili nuk e ka shqipen gjuhë amtare.”
- 13 13 <Κουντρέ> = *kundré* për *kundrejt* < lat. *contrārius* (M)
- 13 14 gr. <Άγορά> = shq. *të blem*. Sipas Lloshit (2018 201) “përkthim i gabuar për “treg, pazar”.

## 5 Përfundime

Shpresojmë të kemi realizuar në këtë punim atë qëllim modest që sinjalizuam qysh në hyrje të tij lidhur me riprodhimin diplomatik dhe

tejskrimin e zgjeruar të fjalësit shqip në fjalorin trigjuhësh greqisht-arumanisht-shqip si pjesë e parë e librit mësimor Πρωτοπειρία (= Përvoja të para, Venedik 1770, f. 13-59) me autor Theodhor Anastas Kavaliotin. Përditësimi i lexuesit me atë qerthull problematik që rrok veprën dhe personalitetin e autorit të saj u trajtua prej shkruarit të këtyre radhëve më fort si detyrim moral ndaj lexuesit shqiptar dhe arumun, çka shpresojmë të mos ketë hijezuar sadopak qëllimin tonë kryesor që është botimi kritik i fjalësit shqip në atë fjalor. Është pikërisht ky fjalës, i cili nuk është bërë ende si i tillë – më saktë në plotësinë e vet! – pronë e rretheve shkencore-intelektuale në hapësirën kulturore shqipfolëse.

Në paraqitjen e kornizës para- dhe peritekstuale të veprës (§§1-4) lexuesit iu përcoll, përpos personalitetit të autorit së bashku me përkatsinë gjuhësore-etnike dhe prurjet e tij në trashëgiminë e Arealit Kulturor ortodoks të Jugut edhe organizimi i kësaj vepre që mbijetoi motet e që ruan sot e gjithë ditën vlerat e saj në fusha të ndryshme të shkencave gjuhësore-filologjike e sosh të tipologjisë areale (Balkansprachbund) dhe të sociolinguistikës. Lexuesi arrin në këtë mënyrë të krijojë vetë një përfytyrim të qartë mbi këtë vepër, duke pjesëmarrë kështu po vetë në diskursin kulturor-social lidhur me atë qerthull problematik që bartin synimet largvajtëse, të cilat mendohet të ketë pasur autori i saj brenda konceptimit dhe realizimit të këtij libri mësimor si doracak për nxënës kombësish të ndryshme (arumune dhe shqiptare), që sapo kishin hyrë në një shkollë me program mësimor greqisht e ku greqishtja pas gjithë gjasash do të përdorej edhe si gjuhë ndërkomunikimi në zhvillimin e atij programi. Andaj edhe përvetësimi i saj parakuptonte sythin e parë didaktik në program.

Puna për riprodhimin diplomatik dhe tejskrimin e zgjeruar të materialit gjuhësor (§§5-6.1) u shoqërua në çdo hap me analizën grafematike-filologjike dhe atë gjuhësore të tekstit (§§4-4.2). Asgjëmangut, në këtë fazë pune tejet të vështirë ndihmuan gjithashtu si përqsasjet në vijimësi me tekstin burimor greqisht ashtu edhe, madje sidomos, sosh me tekstin gjegjës arumanisht, që përcjell në letër karakteristikat e së folmes native të autorit, përkatësisht mënyrën e perceptimit të shqipes dialektore në ndërgegjen e tij gjuhësore. Realizimi i suksesshëm i këtyre fazave të punës me tekstin mundësoi së fundi edhe realizimin e konkordancave leksikore të pjesës shqip (§6), të cilat përcjellin një imazh të qartë të shqipes së folur në Arealin Kulturor ortodoks të Jugut e më gjerë.

Parë nga të gjitha këto perspektiva shpresojmë që teksti dhe autori i saj të bëhen dikur pronë e studimeve shqiptare, duke i dhënë vendin dhe rolin e padiskutueshëm si dëshmitar okular i atij mozaiku gjuhësor-kulturor në një zonë historikisht të njohur për bashkëjetesën ndër-etnike e ndërkonfesionale, bash në atë "...zonë që sendërton Nyjën

e Gordonit në historinë e kulturës së shkrimit shqip, e cila mund të zgjidhet dhe do zgjidhur në bashkëvajtje me njohjen dhe studimin e këtij komponenti sa të ri aq edhe të hershëm të saj; shi të kulturës së shkrimit arumanisht në Arealin Kulturor të Jugut ortodoks brenda hapësirës shqipfolëse.” (Demiraj 2019c 127)

## 6 Bibliografi

ADGJSH: Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe (red. Jorgji Gjinari et al), bl. I-II. Napoli 2007-8.

Ashta, Kolë

2018<sup>2</sup> Theodhor Kavalioti Voskopojari dhe fjalori i tij (1770), në: Leksiku historik i gjuhës shqipe, vol. VII, f. 1-210. Shkodër [vepër postume, e hartuar prej autorit qysh më 1979 – B.D.]

Beza, M.

1934 Biblioteci mănăstirești la Muntele Athos, në: Academia Română, Memoriile secț. Lit., seria a III-a, vol. 7, mem. 3. București.

Capidan, Theodor

1929-30 Fărșeroții. Studiul lingvistic asupra românilor din Albania, në: Dacoromania. Buletinul “Muzeului limbei române” Anul VI 1929-1930. Bucuresti 1-210

1932 Aromânii. Dialectul aromân. Studiu lingvistic, në radhøjën “Studii și cercetări”, bl. XX. Academia Română. București.

Çabej, Eqrem

1936 Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe. Tiranë.

SE Studime etimologjike në fushë të shqipes. Tiranë, bl. II (1975); bl. III (1987); bl. IV (1996); bl. V (2014); bl. VI (2002); bl. VII (2006)

Çunga, Sokol & Demiraj, Bardhyl

2019 Një dorëshkrim shqip në fondin e dorëshkrimeve të Bibliotekës së Manastirit të Shën Trinisë në ishullin Halki, në: “Studime Filologjike” 1-2, f. 205-234. [ribotuar gjermanisht: Ein albanisches Manuskript im Handschriftenbestand der Klosterbibliothek der Heiligen Trinität auf der Insel Chalki, in: „Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikographie und der Philologie der Gegenwart. Akten der 6. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung (27. September

2019, Buçimas bei Pogradec, Albanien)“ (Herausgegeben von Bardhyl Demiraj), në rradojë: „Albanische Forschungen“ bl. 44, Wiesbaden 2020, f. 239-268.]

Daniil Moschopolitis [= Δανιήλ Μοσχοπολίτης]

1802 ΕΙΣΑΓΩΓΙΚΗ ΔΙΔΑΣΚΑΛΙΑ Περιέχουσα Λεξικόν Τετραγλωσσον τῶν τεσσάρων κοινῶν Διαλέκτων ἤτοι τῆς ἀπλῆς Ρωμαϊκῆς, τῆς ἐν Μοισίᾳ Βλαχικῆς, τῆς Βουλγαρικῆς, καί τῆς Ἀλβανικῆς)

Demiraj, Bardhyl

2018 Arumanisht në Kodikun e Kostë Cepi-Vithkuqarit – Homazh Ilo Mitkë Qafëzezit, në: “Studime filologjike” 3-4, f. 105-112. Tiranë.

2019a Kodiku Beratas – Ο Μπερατινός κώδικας (me një botim kritik të pjesës shqip të përgatitur nga Bardhyl Demiraj), ASHSH Tiranë.

2019b Dorëshkrimi shqip në Veneranda Biblioteca Ambrosiana të Milanos (B 112, sup; fol 63<sup>r/v</sup>), në: “Studime” 26 [2019] 43-103. Prishtinë 2020.

2019c Enigma e Gravurës së Ardenicës, në: “Shëjzat – Le Pleiadi” 1-2 [2019] 101-129.

2019<sub>[d]</sub> Sh. më poshtë Qafëzezi 2019<sup>+</sup>.

2019<sub>[e]</sub> Sh. më lart Çunga, Sokol & Demiraj, Bardhyl.

2020a (& Sokol Çunga) Ein albanisches Manuskript im Handschriftenbestand der Klosterbibliothek der Heiligen Trinität auf der Insel Chalki, in: „Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikographie und der Philologie der Gegenwart. Akten der 6. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung (27. September 2019, Buçimas bei Pogradec, Albanien)“ (Herausgegeben von Bardhyl Demiraj), aus der Reihe: „Albanische Forschungen“ Bd. 44, Wiesbaden 2020, S. 239-268

2020b Kodiku i Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822-1823) III. Vendi i tij në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip me alfabet grek, në: “Hylli i Dritës” 1 [2020] 150-188. Shkodër.

2022a Dhanil Voskopojari. Mësim hyrës – Εισαγωγική Διδασκαλία (1802) – me një botim kritik të pjesës shqip, përgatitur nga Bardhyl Demiraj, në: “Radhojtë e Shëjzave”, Tiranë.



- 2022b Alfabeti origjinal i Dhaskal Todhrit në fokusin e analizave etno-kulturore dhe epigrafike të Johan Georg von Hahn-it, in: „Hylli i Dritës“ 1, f. 8-36. Shkodër.
- Desnickaja, Agnia  
 1987 Theodoros Kavalliotis, Daniil, Johan Thunmann und die Anfänge der Balkanologie, në: “Bedeutungen und Ideen in Sprachen und Texten. Werner Bahner gewidmet” (ed. Werner Neumann dhe Bärbel Techtmeier). Berlin, f. 72-83.
- Duka, Ferit  
 2018 Zona Korçë-Voskopojë në fillimet e erës osmane, në: “Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan (Konferencë shkencore ndërkombëtare)”. Tiranë 2018, f. 319-341.
- Exarchos, Giōrgēs = Ἐξαρχος, Γιώργης  
 2016 Πρωτοπειρία Θεοδώρου Αναστασίου Καββαλιώτου. Τριγλώσσο Λέξικο Ρωμαϊκά – Βλάχικα – Αλβανικά. Βενετία-1770. Αθήνα 2016 ([2008]).
- Harald Haarmann  
 1976 Shih më poshtë Thunmann, Johannes 1774.
- Hetzer, Armin  
 1981 Das dreisprachige Wörterverzeichnis von Theodoros Anastasiu Kavalliotis aus Moschopolis, gedruckt 1770 in Venedig. Neubearbeitet, mit dem heutigen Zustande der albanischen Schriftsprache verglichen, sowie mit Einführung und Register versehen von Armin Hetzer. Albanisch-Deutsch-Neugriechisch-Aromunisch. In: BA n.F. (Beiheft, Bd. 1) Hamburg 1981; Aktualisierte Neuausgabe. Hamburg.
- 1981/2 Griechisch in Südalbanien im Zeitalter der Aufklärung. Untersuchungen zu der einem Priester namens Konstandin zugeschrieben Berater Handschrift vom Ende des 18. Jahrhunderts, në: „Münchener Zeitschrift für Balkankunde“ 4, f. 169-218.
- 1983 Neues zu Kavalliotis’ “Prōtopeiria”, në Balkan-Archiv N.F. 8, f. 97-158.
- Jochalas, Titos  
 1980 /To hellêno-albanikon leksikon toy Markoy Mpotsari. Athinai./

- Kastrati, Jup  
2000 Historia e Albanologjisë, vol. I. Tiranë.
- Kavalioti, Thedhor [= Theodōros Anastasios Kaballiōtēs]  
1770 /Prōtopeiria para tou sophologiōtatu/, Venedik 1770 (: ΠΡΩΤΟΠΕΙΡΙΑ παρά τοῦ σοφολογιωτάτου καὶ αἰδεσιμωτάτου Διδασκάλου Ἱεροκλήρυκος, καὶ Πρωτοπαπᾶ Κυρίου ΘΕΟΔΩΡΟΥ ΑΝΑΣΤΑΣΙΟΥ ΚΑΒΑΛΛΙΩΤΟΥ ΤΟΥ ΜΟΣΧΟΠΟΛΙΤΟΥ ΞΥΝΤΕΘΕΙΣΑ. ΕΝΕΤΙΗΣΙΝ 1770)
- Kekridi, Eustathiu N. = Κεκρίδη, Ευστάθιου Ν.  
1991 Θεόδωρος Αναστασίου Καβαλλιώτης 1718-1789 / ο διδάσκαλος του γένους. Καβάλα.
- Kyriazis, Doris K. = Qirjazi, Dhori Q.  
2018 “Thëngjijtë” e pashuar të Voskopojës: grishje për rilexim, në: “Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan (Konferencë shkencore ndërkombëtare)”. Tiranë 2018, f. 244-270.  
2019 Greek-Albanian and Albanian-Greek lexicography in the 18th and 19th centuries. Në: “Studies in Greek Lexicography” (Edited by G. K. Giannakis, Chr. Charalambakis, Fr. Montanari and A. Rengakos) In honor of John N. Kazazis; in the series: “Trends in Classics – Supplementary Volumes”, bl. 72. De Gruyter. Berlin/Boston, pp. 41-56
- Leake, William Martin-  
1814<sup>1</sup> Researches in Greece. London 1814. (Sh. edhe poshtë Lloshi 2006)
- Lloshi, Xhevat  
2006 (Pjesa hyrëse në:) William Martin-Leake: Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe në librin Researches in Greece. Londër, 1814. Përkthyer dhe paraqitur nga prof. dr. Xhevat Lloshi. Tiranë.  
2008 Rreth alfabetit të shqipes. Tiranë.  
2018 Identiteti i Kavaliotit, në: “Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan (Konferencë shkencore ndërkombëtare)”. Tiranë 2018, f. 193-216.
- Meyer, Gustav  
1895 Albanesische Studien. IV. Das griechisch-südrumänisch-albanesische-Wortverzeichnis des Kavalliotis, herausgege-

ben und erklärt, në: "Sitzungsberichte der k. Akademie der Wissenschaften in Wien, phil. Klasse" 132, XII. Wien.

Miklosich, Franz:

- 1882 Rumunische Untersuchungen I. Denkschriften der k.k. Akademie der Wissenschaften, phil. Hist. Cl. 32. BD. 1882: 229-245). Wien.

Omari, Anila

- 2018 Tradita letrare e Elbasanit si pasojë e iluminizmit gjuhësor me rrezatim nga Voskopoja, në: në: "Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan (Konferencë shkencore ndërkombëtare)". Tiranë, f. 278-293.

Osmani, Tomor

- 2008 Udhë e shkronjave shqipe. Tiranë.

Papahagi, Pericle

- 1909 Scriitori Aromâni in secolul al XVIII (Cavalioti, Ucuta, Daniil), București.

Papacostea, Victor

- 1931/2 Teodor Anastasie Cavallioti. Trei manuscrise inedite, në: "Revista istorică română" vol. I MCMXXXI, f. 383-402; vol. II, f. 59-82. (Rishtypur në Papacostea 1983 365-396)
- 1937 Povestea unei cărți. Protopiria lui Cavalioti. "Ein Unicum", në: "Omăgiu lui Const. Kirîțescu". București, f. 665-674. (Rishtypur në Papacostea 1983 397-405)
- 1983 Civilizație românească și civilizație baltanică. Studii istorice. (Ed. Cornelia Papacostea-Danielopolu. Studiu introductiv de N.-Ș. Tanașoca.) București.

Papahagi, Tache

- 1963 Dictionarul dialektului aromân. București.

Peyfuss, Max Demeter

- 1970 Rom oder Byzanz? Das Erwachen des aromunischen Nationalbewusstseins, në: "Österreichische Osthefte" 12, nr. 6, f. 337-351.
- 1985 Marginalien zu Theodor A. Kaballiotis, në: "Österreichische Osthefte" 27, f. 381-388.
- 1989 Die Drückerei von Moschopolis 1731-1769. Buchdruck und Heiligenverehrung im Erzbistum Achrida. Wien – Köln.
- 1998 "Protopiria" lui Cavalioti – un exemplar necunoscut, në:

- “Sud-Est”, vol 9, nr. 3 (33), f. 42-48. Chişinău.
- 2008 Die Protopeiría des Kaballiotis. Bibliophil-bibliologisch-bibliographische Bemerkungen zu einem angeblichen Unicum, në: “Griechische Kultur in Südosteuropa in der Neuzeit. Beiträge zum Symposium in memoriam Gunnar Herin (Wien, 16.-18. Dezember 2004). “Byzantina et Neograeca Vindobonensia”, vol. 26, f. 85-90.
- Pippidi, A.  
1979 Un manuscrit de la “Logique” de Théodore Anastasiu Cavalliotis, në: “Revue des Études Sud.Est Européenes” 17, f. 417-424. Bucarest.
- Qirjazi, Dhori Q. → shih Kyriazis, Doris K.
- Qafëzezi, Ilo Mitkë  
1936/7 Fjalori i Kavalliotit, në: “Leka” VIII, nr. 1–IX, nr. 1. Shkodër.
- 2019<sup>+</sup> (Demiraj, B. – ed.) Ilo Mitkë Qafëzezi: Kodiku i Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822/3) I. Veprimtari krijonjëse – AQSH: Fondi I.M.Q.; D. nr. 52, v. 1938 (përgatiti për botim Bardhyl Demiraj), në: “Studime Filologjike 1-2 [2019] 225-269. Tiranë.
- 2020<sup>+</sup> (Demiraj, B. – ed.) Ilo Mitkë Qafëzezi: Kodiku i Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822/3) I. Veprimtari krijonjëse – AQSH: Fondi I.M.Q.; D. nr. 18, v. 1938 (përgatiti për botim Bardhyl Demiraj), në: “Hylli i Dritës” 2 [2020] 100-130
- Rëmbeçi, Andi  
2018 Dorëshkrim i Teodor Anastas Kavalliotit në AQSH, tregues i veprimtarisë kulturore të shek. XVIII, në: “Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan (Konferencë shkencore ndërkombëtare)”. Tiranë, f. 413-431.
- Ruffini, M.  
1942 Teodor Anastasie Cavallioti, në: “Rivista d’Albania”, vol. 3, nr. 2, f. 110–125. Milano.
- Shuteriqi, Dhimitër  
1976 Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850. Tiranë.
- Thunmann. Johann  
1774 Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker. 1. Theil: Über die Geschichte und Sprache der Albaner und der Wlachen. Leipzig 1774. [(ribotim) Hrsg. u.

mit einer Einleit. Vers. von Harald Haarmann. Hamburg 1976]

Uçi, Alfred

1996 T. A. Kavalioti, un représentant albanais des Lumières, në: "Studia Albanica" III, nr. 2, f. 185–196.


2004 Filozofia e Teodor Anastas Kavaliotit. Tiranë.

Xhufi, Pëllumb

2018 Voskopoja si fenomen ekonomik, në: "Qytetërimi i Voskopojes dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan (Konferencë shkencore ndërkombëtare)". Tiranë 2018, f. 67-84.

## 7 Riprodhime faksimilesh<sup>36</sup>

### 7.1 Ballina e librit



<sup>36</sup> Burime elektronike; < <http://vlahoi.net/vlahiki-glossa/protopeiria-kavallioti> >

## 7.2 Fjalori trigjuhësh (faqe 13)

